



**Republika e Kosovës**

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

01 Numër:30/2022

Data: 25 .03.2022



**Komuna e Istog**

Opština Istok

Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/ SKUPŠTINAOPŠTINE/ MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

KRYESUESI I KUVENDIT

**Për: Anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog**

Me kërkesë të 13 anëtarëve të Kuvendit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës për shkak të mos bllokimit të punës së Kuvendit duke u bazuar në nenin 44 paragrafi 44.1, 44.2, 44.3, 44.4 dhe 44.5 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisjen Lokale; nenin 51 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr. 62/2010; nenin 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL ) Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe nenin 8 paragrafi 1 , 2, 3 dhe 4 të Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Istogut Nr. 2/2013:

## **T H Ë R R A S**

Mbledhjen e Jashtëzakonshme të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës. Mbledhja do të mbahet më: **31.03.2022, ditën e enjte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

## **R E N D D I T E:**

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,
2. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
3. Miratimi i Procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara,
4. Themelimi i Komitetit për politikë e Financa,
5. Themelimi i Komitetit për Komunitete,
6. Themelimi i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB),
7. Formimi i grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
8. Formimi i komisionit të aksionarëve për NK " Stacioni i Autobusëve në Istog " .
9. Themelimi i Komisionit të aksionarëve për KRM " Ambienti " njësia në Istog,
10. Formimi i komisionit për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik Edukativo – Arsimor dhe aftësisë para universitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm.
11. Formimi i komisionit për ndarjen e bursave,
12. Formimi i komisionit për ankesa ndaj ndarjes së bursave,
13. Formimi i Grupit të Grave Asambleiste ,
14. Formimi i Komitetit për Barazi Gjinore,

15. Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2021,
16. Shqyrtimi i Raportit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2021,
17. Shqyrtimi dhe miratimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të komunës me qëllim të zhvillimit ekonomik në aspektin: lokal, urban dhe bujqësor sipas Listës së Veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2022,
18. Pyetje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës.

**Vërejtje :**

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje, t'i referoheni dispozitës së nenit 39 të LVL.

**Kryesuesi i Kuvendit  
z. Enver Rugova**





Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja Inauguruese e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 06.12.2021, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 16:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                                 |                             |
|---------------------------------|-----------------------------|
| 1. Zenel Shatri, LDK;           | 15. Ajshe Metaj, AAK;       |
| 2. Abedin Kabashi, LDK;         | 16. Ardita Idrizaj, AAK;    |
| 3. Enver Rugova, LDK;           | 17. Fjolla Ukaj, AAK;       |
| 4. Naim Behlulaj, LDK;          | 18. Negjdet Ramaj, AAK;     |
| 5. Hajrush Shoshi, LDK;         | 19. Florin Dreshaj, VV;     |
| 6. Agon Dreshaj, LDK;           | 20. Niman Beqiraj, VV;      |
| 7. Faruk Kabashi, LDK;          | 21. Qerim Rexhaj, VV;       |
| 8. Arta Balaj, LDK;             | 22. Floriana Maxharraj, VV; |
| 9. Merita Muzlijaj, LDK;        | 23. Lavdiye Bujupaj, VV;    |
| 10. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; | 24. Ali Nimanaj, PDK;       |
| 11. Valbona Demaj, LDK;         | 25. Arben Kabashi, PDK;     |
| 12. Agron Gashi, AAK;           | 26. Elianë Blakaj, PDK;     |
| 13. Arianit Selmanaj, AAK;      | 27. Rasim Mahmutovic, GIBI  |
| 14. Nexhmedin Balaj, AAK;       |                             |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, qytetarë, zyrtar administrativ, etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, anëtari me i vjetër i kuvendit z. Zenel Shatri.

**Anëtari me i vjetër i Kuvendit, Kryesuesi i mbledhjes z. Zenel Shatri** – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje inauguruese, dhe njofton me rendin e ditës për këtë mbledhje.

Konstaton së të gjithë anëtarët e certifikuar nga KQZ-ja si anëtar të kuvendit Komunal janë prezentë dhe mundë të fillojmë me mbledhjen, vazhdon:

Procesverballi

## **R e n d i t e**

Dhënia e betimit nga anëtarët e Kuvendit të Komunës  
Dhënia e betimit të Kryetarit të Komunës  
Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës  
Fjala përshëndetëse e Ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal  
(MAPL-së )Mbyllja e mbledhjes

Kryesues i mbledhjes z. Zenel Shatri – thërret të gjithë anëtarët e zgjedhur të kuvendit komunal që të ngrihen në këmbë dhe të japin betimin.  
Si dhe ta nënshkruajnë deklaratën e dhënies se betimit.

Të gjithë anëtarët e kuvendit dhanë betimin dhe nënshkruan deklaratën,  
(deklaratat e nënshkruara me dosjen e anëtarit të kuvendit gjinden në zyrën e kuvendit).

Kryesues i mbledhjes – i uron anëtarët e Kuvendit për mandatin e marrë dhe ju uron suksese dhe punë mbarë gjatë këtij mandati katër vjeçar.  
Fton Kryetarin e Komunës të jep betimin.

### **Shqyrtimi i pikës dy**

Kryesuesi i mbledhjes, z. Zenel Shatri – fjalën ja kalon kryetarit të komunës z. Ilir Ferati, për dhenjën e betimit para anëtareve të Kuvendit të Komunës, dhe fjalën përshëndetës.

Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati – Jepe betimin dhe nënshkruan deklaratën,  
(deklarata e nënshkruar gjindte në dosjen e zyrës së kuvendit komunal)

Përshëndet të gjithë të pranishmit, (Të gjithë qytetaret e komunës së Istogut, kryetarin e deri tanishëm z. Haki Rugova, Asamblistët, dhe të gjithë të pranishmit tjerë që gjendeshin në sallë), falënderon të gjithë qytetaret e komunës së Istogut për besimin e dhen qe të qeverisim bashke, të gjitha premtimet e dhëna do të mundohem qe ti realizojmë se bashku.

Kryesues i mbledhjes, z. Zenel Shatri – uron kryetarin dhe i dëshiron suksese dhe mbars i në punë,

### **Shqyrtimi i pikës se tretë**

Kryesues i mbledhjes – fton të marr fjalën Ministri i MAPL z.

Ministri i MAPL-së, z. Elbert Krasniqi – përshëndet të gjithë të pranishmit, kryetarit i uron suksese, dhe shprehë gatshmërin për bashkëpunim dhe përkrahje të vazhdueshme.

Kryesues i mbledhjes z. Zenel Shatri – falënderon Ministrit për fjalën. Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.  
Shpall mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 16:35.

**Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,  
Zenel Shatri**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e tret e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 03.02.2022, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                                 |                             |
|---------------------------------|-----------------------------|
| 1. Zenel Shatri, LDK;           | 14. Ajshe Metaj, AAK;       |
| 2. Abedin Kabashi, LDK;         | 15. Ardita Idrizaj, AAK;    |
| 3. Enver Rugova, LDK;           | 16. Fjolla Ukaj, AAK;       |
| 4. Naim Behlulaj, LDK;          | 17. Negjdet Ramaj, AAK;     |
| 5. Hajrush Shoshi, LDK;         | 18. Nexhmedin Balaj, AAK;   |
| 6. Agon Dreshaj, LDK;           | 19. Florin Dreshaj, VV;     |
| 7. Faruk Kabashi, LDK;          | 20. Niman Beqiraj, VV;      |
| 8. Arta Balaj, LDK;             | 21. Floriana Maxharraj, VV; |
| 9. Merita Muzlijaj, LDK;        | 22. Lavdije Bujupaj, VV;    |
| 10. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; | 23. Arben Kabashi, PDK;     |
| 11. Valbona Demaj, LDK;         | 24. Elianë Blakaj, PDK;     |
| 12. Agron Gashi, AAK;           | 25. Rasim Mahmutovic, GIBI  |
| 13. Arianit Selmanaj, AAK;      |                             |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: përfaqësues të OSBE-së zyrtar administrativ, etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës znj. Fjolla Ukaj** – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Konstaton se kuorumi ekziston 25 anëtarët të kuvendit të Komunës janë prezentë dhe mundë të fillojmë me pikat e rendit të ditës:

### R e n d d i t e

## Pika 1

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,  
Konstaton së janë 25 anëtar të pranishëm , kuorumi për vazhdimin e mbledhjes është dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen e tret të legjislacionit të legjislacionit të shtat të Kuvendi të Komunës.

## Pika 2

2. Arsyeimi i mungesave në mbledhje,  
Në mbledhje mungojnë  
vetëm Qerim Rexhaj – LVV dhe Ali Nimanaj PDK, as njëri nuk ka njoftuar për mos prezencën e tyre.

## Pika 3

3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluar ,  
A keni ndonjë vërejtje apo sugjerim.  
Pasi askush nuk ka diçka e hedhim në votim kush është për

Fjalën ja kalon Arben Kabashit.

Arben Kabashi, PDK – përshëndet të gjithë të pranishmit , nuk e di a e keni lexuar Rregulloren e Kuvendit së pari kur të janë pikat e rendit të ditës duhet të qitet në aprovim a po kalon apo jo, ose nëse ka dikush ndonjë pik apo diçka tjetër, u thy Rregullorja fill në starte, këtë merre si vërejtje apo si të duash.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës znj. Fjolla Ukaj – atëherë i hedhim në votim, kush është për.

Fjalën ja kalon Enver Rugoves.

Enver Rugova, LDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, konsideroj se kjo mbledhje është thirrur shumë me vonës, duke i ditur pikat e rendit të ditës rendësin e tyre që është formimi i komiteteve funksionale të kuvendit si dhe formimi i grupit punues për zhvillimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2022, ne e dimë që me 5 janar në një zgjedhje demokratike kryesuesen e kemi pasur procedura ka shkuar në rregull edhe Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale e përcakton që faktikisht sa ma shpejt që është e mundshme të zgjidhen trupat e kuvendit ne kemi pritur një muaj rrafsh që të thirret mbledhja kështu që e konsideroj një shkelje të madhe ose një vonës shumë të madhe pa e personalizuar ose pa e politizuar këtë, po ua them sinjerisht që pesë mandate jam këtu anëtar i kuvendit dhe kjo nuk na ka ndodhur janë vonuar shumë procese edhe zhvillime të kuvendit po kuvendi faktikisht edhe ekzekutivi varet nga puna e tyre komiteteve apo atyre trupave punuese siç është Komitetit për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete, si dhe plani i punës normal punën e Kuvendit për vitin 2022.

Sa i përket edhe disa çështjeve tjera funksionale e nderuara Kryesuese e kam par që është mbajtur një mbledhje e kolegjiut të kryesuesve të Kosovës në nivel vendi edhe ne nuk jemi të informuar edhe pse është rregull Kryesuesi të informoj Kuvendin për çka është vendos atje ku jemi me trupat, ose ku është kryesuesi vetë i komunës tonë në kuadër të kësaj se di a e keni vërejtur. Se di a e keni vërejtur të hënën faktikisht nuk janë procesuar pagat që ju e keni për detyrë me i përcjell këto bashke me sekretarin që është këtu zyrtarja, ju e keni për detyrë bashke me të me i përcjell këto, ka këshilltar këtu që se paku tre prej tyre nuk janë në listën e pagave fare, një nga ta jam edhe vetë ne jetojmë me ato paga edhe faktikisht ju e përmendet që është mbledhja e tret e legjislaturës së shtatë ashtu është ne nuk i kemi marr pagat ose i kemi marr percjalisht disa prej tyre kanë marr vetëm njëqind euro. Dhe ju kanë dal në mënyrë shumë parciale ose jo të mirë me vjen keq me të thënë por është dashur me i përcjell këto gjëra e di që je e punësuar dikund tjetër por çështjet e kuvendit e dojnë një permanenc shumë të madhe po konsideroj që faktikisht edhe këtu ke neglizhuar nuk desha ta përmend atë hyrjen e juaj që e dhatë aty ajo ishte shkelje e rregullave të Kuvendit faktikisht duhet me e qitë rendin e ditës me pikat në votim pastaj të përmenden pikat e rendit të ditës por ta lemë këtë unë me keqardhje me duhet të them që si koalicion që jemi të zyrtarizuar dje edhe si emër, të gjithë këtyre këshilltarëve nuk do të participojmi në këtë mbledhje.

(Debat mes anëtarëve të kuvendit)

Kryesuesja e Kuvendit znj. Fjolla Ukaj – sa i përket shtyrjes së seancës që nuk e kemi thirrur deri me sot, çdo kohë kam qen në kontakt me kryetarin, prej kryetarit është kërkuar që të mos thirret seancë për arsyen se aj ka dashur të dal me drejtori dhe me komplet stafin e tij arsyeja ka qen prej tij qe mos të thirr seancë meqë aj nuk ka qenë i përgatitur të del me staf. Kamë qen në kontakt me kryetarin ka qen sekretaresha, nuk është problemi pse unë nuk e kamë thirrur, kjo është në përgjegjësin kryetarit.

Florin Dreshaj, LVV – përshëndet të gjithë të pranishmit, mos u shqetëso ata e kishin pas planifikuar këtë far skenari, është hera e parë që po mban mbledhje në qoftë se e ke harru me thanë që duhet me aprovu rendin e ditës nuk është ndonjë kiamet u pa që ishin qenë të përgatitur edhe ato shkeljet qe i thojke Enveri si shkelje ato nuk ekzistojnë as një, ato ishin thjeshtë rrena të Enverit çfarë ligji ose çfarë neni ose çka ka qe ki shkel ti, me paga nuk merresh ti, me falni qe po ju drejtona me ti znj. Kryesuese ju nuk merreni me paga nuk është punë e juaja. Enveri vetëm u mendojke me i qit do sende çka nuk ekzistojnë, do të thotë është Pazar i tyre i ndyte qe e kanë bërë. Edhe me së pari janë ata PDK-ja që na kanë thirrur vet me e zgjedh një kryesues të përbashkët e sot kur i shisha mu doken sikur Bejta-Syla ndoshta e dini atë historinë e vëllazërive kastrati e atë çka e kanë fitu e pata në plan me ua them faqen e zezë dhe ni par këpucë. Kështu qe mos u shqetëso për atë punë nuk e di a kemi kuorum për të vazhduar.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Fjolla Ukaj – nuk kemi kuorum për të vazhduar. Dhe mbledhja do të përfundoj këtu.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:27.



**Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,  
Zenel Shatri**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e tret e Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 03.02.2022, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                                 |                             |
|---------------------------------|-----------------------------|
| 1. Zenel Shatri, LDK;           | 14. Ajshe Metaj, AAK;       |
| 2. Abedin Kabashi, LDK;         | 15. Ardita Idrizaj, AAK;    |
| 3. Enver Rugova, LDK;           | 16. Fjolla Ukaj, AAK;       |
| 4. Naim Behlulaj, LDK;          | 17. Negjdet Ramaj, AAK;     |
| 5. Hajrush Shoshi, LDK;         | 18. Nexhmedin Balaj, AAK;   |
| 6. Agon Dreshaj, LDK;           | 19. Florin Dreshaj, VV;     |
| 7. Faruk Kabashi, LDK;          | 20. Niman Beqiraj, VV;      |
| 8. Arta Balaj, LDK;             | 21. Floriana Maxharraj, VV; |
| 9. Merita Muzlijaj, LDK;        | 22. Lavdije Bujupaj, VV;    |
| 10. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; | 23. Arben Kabashi, PDK;     |
| 11. Valbona Demaj, LDK;         | 24. Elianë Blakaj, PDK;     |
| 12. Agron Gashi, AAK;           | 25. Rasim Mahmutovic, GIBI  |
| 13. Arianit Selmanaj, AAK;      |                             |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: përfaqësues të OSBE-së zyrtar administrativ, etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

**Kryesuesja e Kuvendit të Komunës znj. Fjolla Ukaj** – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Konstaton së kuorumi ekziston 25 anëtarët të kuvendit të Komunës janë prezentë dhe mundë të fillojmë me pikat e rendit të ditës:

### R e n d d i t e

## Pika 1

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të Kuvendit,  
Konstaton së janë 25 anëtar të pranishëm , kuorumi për vazhdimin e mbledhjes është dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen e tret të legjislacionit të legjislacionit të shtat të Kuvendi të Komunës.

## Pika 2

2. Arsyeimi i mungesave në mbledhje,  
Në mbledhje mungojnë  
vetëm Qerim Rexhaj – LVV dhe Ali Nimanaj PDK, as njëri nuk ka njoftuar për mos prezencën e tyre.

## Pika 3

3. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluar ,  
A keni ndonjë vërejtje apo sugjerim.  
Pasi askush nuk ka diçka e hedhim në votim kush është për

Fjalën ja kalon Arben Kabashit.

Arben Kabashi, PDK – përshëndet të gjithë të pranishmit , nuk e di a e keni lexuar Rregulloren e Kuvendit së pari kur të janë pikat e rendit të ditës duhet të qitet në aprovim a po kalon apo jo, ose nëse ka dikush ndonjë pik apo diçka tjetër, u thy Rregullorja fill në starte, këtë merre si vërejtje apo si të duash.

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës znj. Fjolla Ukaj – atëherë i hedhim në votim, kush është për.

Fjalën ja kalon Enver Rugoves.

Enver Rugova, LDK – përshëndet të gjithë të pranishmit, konsideroj se kjo mbledhje është thirrur shumë me vonës, duke i ditur pikat e rendit të ditës rendësin e tyre që është formimi i komiteteve funksionale të kuvendit si dhe formimi i grupit punues për zhvillimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2022, ne e dimë që me 5 janar në një zgjedhje demokratike kryesuesen e kemi pasur procedura ka shkuar në rregull edhe Ligji mbi Vetëqeverisjen Lokale e përcakton që faktikisht sa ma shpejt që është e mundshme të zgjidhen trupat e kuvendit ne kemi pritur një muaj rrafsh që të thirret mbledhja kështu që e konsideroj një shkelje të madhe ose një vonës shumë të madhe pa e personalizuar ose pa e politizuar këtë, po ua them sinjerisht që pesë mandate jam këtu anëtar i kuvendit dhe kjo nuk na ka ndodhur janë vonuar shumë procese edhe zhvillime të kuvendit po kuvendi faktikisht edhe ekzekutivi varet nga puna e tyre komiteteve apo atyre trupave punuese siç është Komitetit për Politikë e Financa dhe Komiteti për Komunitete, si dhe plani i punës normal punën e Kuvendit për vitin 2022.

Sa i përket edhe disa çështjeve tjera funksionale e nderuara Kryesuese e kam par që është mbajtur një mbledhje e kolegjiut të kryesuesve të Kosovës në nivel vendi edhe ne nuk jemi të informuar edhe pse është rregull Kryesuesi të informoj Kuvendin për çka është vendos atje ku jemi me trupat, ose ku është kryesuesi vetë i komunës tonë në kuadër të kësaj se di a e keni vërejtur. Se di a e keni vërejtur të hënën faktikisht nuk janë procesuar pagat që ju e keni për detyrë me i përcjell këto bashke me sekretarin që është këtu zyrtarja, ju e keni për detyrë bashke me të me i përcjell këto, ka këshilltar këtu që se paku tre prej tyre nuk janë në listën e pagave fare, një nga ta jam edhe vetë ne jetojmë me ato paga edhe faktikisht ju e përmendet që është mbledhja e tret e legjislaturës së shtatë ashtu është ne nuk i kemi marr pagat ose i kemi marr percjalisht disa prej tyre kanë marr vetëm njëqind euro. Dhe ju kanë dal në mënyrë shumë parciale ose jo të mirë me vjen keq me të thënë por është dashur me i përcjell këto gjëra e di që je e punësuar dikund tjetër por çështjet e kuvendit e dojnë një permanenc shumë të madhe po konsideroj që faktikisht edhe këtu ke neglizhuar nuk desha ta përmend atë hyrjen e juaj që e dhatë aty ajo ishte shkelje e rregullave të Kuvendit faktikisht duhet me e qitë rendin e ditës me pikat në votim pastaj të përmenden pikat e rendit të ditës por ta lemë këtë unë me keqardhje me duhet të them që si koalicion që jemi të zyrtarizuar dje edhe si emër, të gjithë këtyre këshilltarëve nuk do të participojmi në këtë mbledhje.

(Debat mes anëtarëve të kuvendit)

Kryesuesja e Kuvendit znj. Fjolla Ukaj – sa i përket shtyrjes së seancës që nuk e kemi thirrur deri me sot, çdo kohë kam qen në kontakt me kryetarin, prej kryetarit është kërkuar që të mos thirret seancë për arsyen se aj ka dashur të dal me drejtori dhe me komplet stafin e tij arsyeja ka qen prej tij qe mos të thirr seancë meqë aj nuk ka qenë i përgatitur të del me staf. Kamë qen në kontakt me kryetarin ka qen sekretaresha, nuk është problemi pse unë nuk e kamë thirrur, kjo është në përgjegjësin kryetarit.

Florin Dreshaj, LVV – përshëndet të gjithë të pranishmit, mos u shqetëso ata e kishin pas planifikuar këtë far skenari, është hera e parë që po mban mbledhje në qoftë se e ke harru me thanë që duhet me aprovu rendin e ditës nuk është ndonjë kiamet u pa që ishin qenë të përgatitur edhe ato shkeljet qe i thojke Enveri si shkelje ato nuk ekzistojnë as një, ato ishin thjeshtë rrena të Enverit çfarë ligji ose çfarë neni ose çka ka qe ki shkel ti, me paga nuk merresh ti, me falni qe po ju drejtona me ti znj. Kryesuese ju nuk merreni me paga nuk është punë e juaja. Enveri vetëm u mendojke me i qit do sende çka nuk ekzistojnë, do të thotë është Pazar i tyre i ndyte qe e kanë bërë. Edhe me së pari janë ata PDK-ja që na kanë thirrur vet me e zgjedh një kryesues të përbashkët e sot kur i shisha mu doken sikur Bejta-Syla ndoshta e dini atë historinë e vëllazërive kastrati e atë çka e kanë fitu e pata në plan me ua them faqen e zezë dhe ni par këpucë. Kështu qe mos u shqetëso për atë punë nuk e di a kemi kuorum për të vazhduar.

Kryesuesja e Kuvendit znj. Fjolla Ukaj – nuk kemi kuorum për të vazhduar. Dhe mbledhja do të përfundoj këtu.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:27.

**Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,  
Zenel Shatri**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja Urgjente të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 09.02.2022, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                                 |                             |
|---------------------------------|-----------------------------|
| 1. Zenel Shatri, LDK;           | 12. Florin Dreshaj, VV;     |
| 2. Abedin Kabashi, LDK;         | 13. Niman Beqiraj, VV;      |
| 3. Enver Rugova, LDK;           | 14. Qerim Rexhaj, VV;       |
| 4. Naim Behlulaj, LDK;          | 15. Floriana Maxharraj, VV; |
| 5. Hajrush Shoshi, LDK;         | 16. Lavdije Bujupaj, VV;    |
| 6. Agon Dreshaj, LDK;           | 17. Ali Nimanaj, PDK;       |
| 7. Faruk Kabashi, LDK;          | 18. Arben Kabashi, PDK;     |
| 8. Arta Balaj, LDK;             | 19. Elianë Blakaj, PDK;     |
| 9. Merita Muzlijaj, LDK;        | 20. Rasim Mahmutovic, GIBI  |
| 10. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; |                             |
| 11. Valbona Demaj, LDK;         |                             |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, përfaqësues të OSBE-së (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Pasi që në mbledhje nuk ishte kryesuesja e kuvendit të komunës, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, anëtari me i vjetër i kuvendit z. Zenel Shatri.

Bazuar në

**Anëtari me i vjetër i Kuvendit, Kryesuesi i mbledhjes z. Zenel Shatri** – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Të nderuar anëtar bazuar në nenin 42 paragrafi 42.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i "lexon nenin", andaj pasi që në mbledhje nuk merr pjesë kryesuesja e kuvendit ligji me obligon mua si anëtari me i vjetër i kuvendit ta kryesoj këtë mbledhjen, megjithatë megjithatë kërkoj nga ju që ta qesim në votim a jeni për, që ta udhëheq unë këtë mbledhje.

Procesverbali

**Hedh në votim:**

**15 vota për, Kundër 5, Abstenim 0**

**Konstaton që me 15 vota për vazhdon që ta kryesoj mbledhjen.**

Konstaton së kuorumi ekziston 20 anëtarët të kuvendit të Komunës janë prezentë dhe mundë të fillojmë me mbledhjen, vazhdon:

## **R e n d d i t e**

1. Shkarkimi i Kryesueses së Kuvendit të Komunës të komunës së Istogut.

**Hedh në miratim rendin e ditës**

**15 vota për, 5 kundër, dhe abstenim nuk ka.**

**Kryesuesi i mbledhjes konstaton se rendi i ditës u miratua me 15 vota për.**

Kryesuesi i mbledhjes – paraqet arsyen e thirrjes së mbledhjes, siç jeni të njoftuar me kërkesën tonë dhe të kryetarit jemi mbledhur në këtë mbledhje urgjente edhe pse ne si anëtar kemi kërkuar mbledhjen e jashtëzakonshme nga kryesuesja e kuvendit znj. Fjolla Ukaj e cila ka refuzuar kërkesën tonë dhe për të cilën është njoftuar edhe kryetari i komunës dhe duke u bazuar në refuzimin e kërkesës tonë prej kryesueses së kuvendit e cila ka pasur obligim ligjor ta thërras mbledhjen e jashtëzakonshme gjë të cilën nuk e ka bërë e cila ligjërisht obligohet ta thërras mbledhjen e jashtëzakonshme të kuvendit të komunës sipas kërkesës së 1/3 të anëtarëve të Kuvendit të Komunës apo kërkesës së kryetarit e cila është e përcaktuar me nenin 38 paragrafi 4 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Neni 44 paragrafi 44.1 , 44.2 dhe 44.3, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, dhe neni 5 paragrafi 2 Udhëzim Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe neni 8 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Komunale 01 Nr. 14/013 të datës 29.03.2013 për punën e kuvendit të Komunës së Istogut.

Bazuar në arsyet e lartcekura mbledhja urgjente është thirrur nga Kryetari i Komunës. Andaj hedhë në votim Shkarkimin e Kryesueses së Kuvendit të Komunës.

**Hedh në votim**

**Kushte është për:**

**15 vota për, 0 kundër dhe 0 abstenim.**

**Konstatohet që me 15 votash për, Shkarkohet Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Istogut.**

**Nga salla largohen anëtarët e VV. ( nuk marrin pjesë në votim).**

**Konstaton që Kuorumi është 15 anëtar të pranishme në sallën e Kuvendit.**

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.  
Shpall mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:30.

**Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,  
Zenel Shatri**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Jashtëzakonshme të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 15.02.2022, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                                 |                             |
|---------------------------------|-----------------------------|
| 1. Zenel Shatri, LDK;           | 14. Nexhmedin Balaj, AAK;   |
| 2. Abedin Kabashi, LDK;         | 15. Ajshe Metaj, AAK;       |
| 3. Enver Rugova, LDK;           | 16. Ardita Idrizaj, AAK;    |
| 4. Naim Behlulaj, LDK;          | 17. Fjolla Ukaj, AAK;       |
| 5. Hajrush Shoshi, LDK;         | 18. Negjdet Ramaj, AAK;     |
| 6. Agon Dreshaj, LDK;           | 19. Florin Dreshaj, VV;     |
| 7. Faruk Kabashi, LDK;          | 20. Niman Beqiraj, VV;      |
| 8. Arta Balaj, LDK;             | 21. Floriana Maxharraj, VV; |
| 9. Merita Muzlijaj, LDK;        | 22. Lavdije Bujupaj, VV;    |
| 10. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; | 23. Ali Nimanaj, PDK;       |
| 11. Valbona Demaj, LDK;         | 24. Arben Kabashi, PDK;     |
| 12. Agron Gashi, AAK;           | 25. Elianë Blakaj, PDK;     |
| 13. Arianit Selmanaj, AAK;      | 26. Rasim Mahmutovic, GIBI  |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, përfaqësues të OSBE-së (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, anëtari me i vjetër i kuvendit z. Zenel Shatri.  
Bazuar në

**Anëtari me i vjetër i Kuvendit, Kryesuesi i mbledhjes z. Zenel Shatri** – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

Konstaton Kuorumin për mbajtjen e mbledhjes nga 27 anëtar të Kuvendit një mungon dhe në sall janë vetëm 26 anëtar të Kuvendit të Komunës.

Procesverballi



Niman Beqiraj, LVV - përshëndet të gjithë të pranishmit dhe njofton se z. Qerim Rexhaj për shkaqe shëndetësorë mungon ( ka pasur një ndërhyrje kirurgjike dhe ndodhet në spital në Prishtinë) .

Kryesuesi i mbledhjes z. Zenel Shatri – kuorumi e kemi dhe mund të vazhdojmë me mbledhjen.

Së pari paraqet arsyet e thirrjes së mbledhjes te Jashtëzakonshme:

Mbledhja është thirrur me kërkesën e me shumë se 1/3 e anëtarëve të kuvendit nga 15 anëtar të Kuvendit të Komunës, ashtu siç na lejojnë dispozitat ligjore kjo ka ardhur si rezultat i mbledhjes urgjente të mbajtur me 09.02.2022, në të cilën nga 20 anëtar të Kuvendit të Komunës 15 prej tyre sa edhe ishin të pranishëm në procesin e votimit, votuan për shkarkimin e kryesueses së kuvendit të komunës së Istogut, znj. Fjolla Ukaj. Bazuar në nenin 42 paragrafi 42.5 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale i “lexon nenin” , andaj ligji me obligon mua si anëtar me i vjetër i kuvendit ta kryesoj mbledhjen, megjithatë kërkoj nga ju që ta qesim në votim a jeni për, që ta udhëheq unë këtë mbledhje.

**Hedh në votim:**

**Për 15, Kundër 4, Abstenim 0 , dhe 7 nuk votojnë fare.**

**Konstaton që me 15 vota për vazhdon që ta kryesoj mbledhjen anëtar me i vjetër i kuvendit z. Zenel Shatri.**

Konstaton së kuorumi është 26 anëtarët të kuvendit të Komunës janë prezentë.

Vazhdojmë në mbledhjen :

## **R e n d d i t e**

1. Zgjedhja e Kryesuesit te Kuvendit te Komunës.

**Hedh në miratim rendin e ditës**

**Për 15, kundër 11, dhe abstenim 0.**

**Kryesuesi i mbledhjes konstaton se rendi i ditës u miratuat me 15 vota për.**

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale neni 41, udhëzimi Administrativ Nr.2009/1 për Procedurën e Zgjedhjes dhe Përgjegjësit e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës.

“sqaron procedurat dhe lexon udhëzimin Administrativ të lartcekur”

Pyet se prej sa anëtarësh dëshironi të këtë përbërje komisioni 3 apo 5

Kush është që komisioni të këtë përbërjen prej 3 anëtarësh

**Hedh në votim,**

**Për 15, kundër 0, abstenim 0**

**Miratohet me 15 vota për që komisioni të jetë prej tre anëtarëve.**

Vazhdojmë me propozimet për këtë komision:

Agon Dreshaj, LDK – nga radhët e LDK-së propozon Valbone Demaj,

Agron Gashi, AAK – përshëndet të gjithë të pranishmit, AAK-ja nuk propozon anëtar të komisionit dhe arsyeja pse ne abstenum gjatë udhëheqjes tuaj si kryesues është sepse pas çdo seance ne e dimë që vjen një vendim për ligjshmërinë e asaj seance ne nuk kemi marr vendim me shkrim për shkarkimin e kryesueses dhe e shohim si të jashtëligjshëm këtë mbledhje, pasi që nuk e kemi vendimin për shkarkimin e kryesueses nuk mundemi ne me mbajt një mbledhje me zgjedh një kryesues të ri ku nuk ka ardhur vendimi legjitim nga MAPL-ja për shkarkimin e kryesueses ne tash në këtë mbledhje po i bëjmë dy kryesues a ka mundësi dikush nga ju me ma interpretu se a ka vendim për shkarkimin e kryesueses dhe ne pastaj dalim me qëndrimin tonë, përndryshe ne nuk vendosim anëtar në komision as nuk e shohim të ligjshme këtë seanc, as nuk votojmë për ju për ata abstenuam, sepse kjo seanc është e jashtëligjshme për momentin që nuk ka ardhur një vendim për shkarkimin e kryesueses. Kryesuesja është shkarkuar dhe ne e dim se pas çdo mbledhje MAPL-ja dërgon ligjshmërinë pas çdo seancë, ne nuk kemi marr me shkrim asgjë as kryesuesja as grupi jonë nëse kini ju me shkrim diçka shpallje të ligjshmëris të shkarkimit të kryesueses atëherë shfaqne nëse jo atëherë kjo seanc është e jashtëligjshme. Nuk mund të shpallet një kryesues i ri kur nuk është shpallur shkarkimi i kryesueses së kaluar që për momentin është aktuale.

Merren sqarimet nga sekretaria e Kuvendit,

Janë afatet ligjore për konfirmimin e ligjshmërisë së vendimeve, por deri atëherë ne nuk mund ta bllokojmë punën e Kuvendit.

Kryesuesi i mbledhjes vazhdojmë me propozimet e komisionit për verifikim.

Florin Dreshaj, LVV - përshëndet të gjithë të pranishmit, lëvizja vetëvendosje nuk do të marr pjesë në një proces të jashtëligjshëm, siç e tha edhe parafolësi kjo mbledhje është e jashtëligjshme edhe nuk do të jem pjesë e saj.

#### **(nga mbledhja largohen anëtarët e AAK-së dhe e LVV)**

Kryesuesi i mbledhjes – konstaton kuorumin në sall janë 15 anëtar të Kuvendit të komunës, kuorumi është dhe mund të vazhdojmë me propozimet tjera.

Arben Kabashi, PDK - nga radhët e PDK-së propozon znj. Eljan Blakaj,  
Faruk Kabshi, LDK – nga radhët e GIBI –it propozon Rasim Mahmutovic

I kemi tre anëtar të kuvendit të propozuar në komisioni:

1. Valbone Demaj, LDK
2. Eljan Blakaj, PDK dhe
3. Rasim Mahmutovic, GIBI.

Lut qytetaret që për shkak të hapësirës dhe votimi të lirshëm ta lirojnë sallën.  
Ju lutem të mirëkuptohemi.

Fillojmë me Propozimet për kryesues të Kuvendit të Komunës:

Naim Behlulaj, LDK – propozon për kryesues të kuvendit të komunës z. Enver Rugova nga radhët e LDK-së.

Kryesuesi i mbledhjes – pret a ka propozimet tjera.

Pasi që propozime tjera nuk ka,  
Thërret sekretarin e Kuvendit që të bëjë përgatitjen e votimit.

Pasi që sekretaria e Kuvendit beri të gjitha përgatitjet e duhura.  
Dhe vazhdojmë me votim,  
Nga sekretaria kanë ardhur 15 fletë votime, lista me emrat e anëtareve të kuvendit e cila duhet të nënshkruhet nga të gjithë votuesit, të cilat u verifikuan nga komisioni, dhe janë në rregull.

Komisioni i përzgjedhur për mbarëvajtjen e votimit fillon me punë, thërret anëtarët e Kuvendit me listë dhe merr nënshkrimet e tyre ashtu siç janë në bazë të renditjes.

Të gjithë anëtarët e Kuvendit të komunës që janë prezent votojnë në mënyrë të fshehtë.  
Mbarëvajtja e votimit shkon në rregull pa probleme.

Pas votimit komisioni,  
Konstaton se votimi ka përfunduar në mënyrë të rregullt.  
Fillojnë me numërimin e votave:  
Komisioni konstaton se nga 15 vota gjithsejtë:  
Ku të gjitha, 15 vota ka marrë Enver Rugova – LDK,

Kryesues i Kuvendit të komunës së Istogut zgjidhët z. Enver Rugova.

Kryesues i mbledhjes – pasi që komisioni përfundoj punën, kryesuese i kuvendit për legjislacionit të VII-të, u zgjodh zi. Enver Rugova nga radhët e LDK-së, i uron për marrë e detyrës dhe i dëshiron punë të mbar.  
Fton që kryesuesi i ta marr detyrën dhe të ulet ne vendin e kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Istogut .  
Dhe e fton për një fjalë rasti.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Enver Rugova – përshëndet të gjithë të pranishmit, dhe falënderon për besimin e dhënë, shpreh gatshmerin dhe bashkëpunimin me të gjithë.

Kryetari i Komunës, z. Ilir Ferati, i uron Kryesuesit të Kuvendit për marrjen e mandatit dhe i uron punë të mbar, dhe bashkëpunim në këtë mandat.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z. Enver Rugova - Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.  
Shpall mbledhjen e mbyllur mbledhjen.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:45.

**Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,  
Zenel Shatri**



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja Urgjente të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 25.03.2022, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                         |                                 |
|-------------------------|---------------------------------|
| 1. Enver Rugova, LDK;   | 9. Njomza Demaj, LDK;           |
| 2. Hajrush Shoshi, LDK; | 10. Liridona Lajqi Avdiaj, LDK; |
| 3. Faruk Kabashi, LDK;  | 11. Valbona Demaj, LDK;         |
| 4. Haki Podrimaj, LDK;  | 12. Visar Haxhijaj, PDK;        |
| 5. Ruzhdi Metaj, LDK;   | 13. Era Visoqi, PDK;            |
| 6. Faik Alushaj, LDK;   | 14. Andi Xhuraj, PDK;           |
| 7. Veton Kurti, LDK;    | 15. Melis Smakic, GIBI          |
| 8. Arta Balaj, LDK;     |                                 |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm: Nënkryetari i Komunës z. Ali Nimanaj, Drejtoret e Drejtorive, përfaqësues të OSBE-së, zyrtar administrativ , mediat (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverballi dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës z. Enver Rugova** – përshëndeti të gjithë të pranishmit në këtë mbledhje.

**Para se të procedojmë me rendin e ditës për nder të jetës dhe veprës së znj. Madeleine Albright, miken e të gjithë shqiptarëve.**

### LAVDI

Vazhdojmë me mbledhjen

Në bazë të nenit 44 paragrafi 44. 6 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 51 paragrafi 51.6 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr. 62/2010. neni 7 paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Si dhe neni 8 paragrafi 6 i Rregullores së Punës së Kuvendit të Komunës së Istogut Nr. 2/2013.

Procesverbali

Duke u bazuar në shkresën e MAPL-së të datës 23.03.2022, për shkak të mos respektimit të afatit ligjor të përcaktuar në neni 43 paragrafi 43.3, anulohet mbledhja e Kuvendit të Komunës e mbajtur me 15.03.2022 .

Për shkak të mos bllokimit pasi që jemi në një fazë të raportimit buxhetore të vitit 2021 edhe të shumë pikave tjera ne sot kemi thirrur seancë urgjente, e kemi një pikë:

## **R e n d   d i t e**

### **1. Dhënia e Betimit të anëtarëve të kuvendit të Komunës.**

Konstaton kuorumin për procedimin 15 anëtar prezent dhe mund të vazhdojmë me rendin e ditës.

Duke u bazuar në Ligji për Vetëqeverisje Lokale neni 35 paragrafi 35.3 dhe 35.4

Ftoj anëtarin me të vjetër që nuk e ka dhen betimin që të lexoj deklaratën solemne Betimin.

Anëtarët të cilët duhet ta japin betimin sot të ngrihen në këmbë

Nëntë anëtarët e kuvendit të komunës dhanë betimin dhe nënshkruan deklaratën, (deklaratat e nënshkruara me dosjen e anëtarit të kuvendit gjinden në zyrën e kuvendit).

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – informon anëtarët se për rrjedhën dhe ecurinë e mbledhjes kemi kontaktuar me Ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal, departamenti ligjor për monitorimin e komunave dhe ata na kanë udhëzuar që të procedojmë në këtë mënyrë.

Ju uroj shëndet dhe punë të mbar, suksese.

Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje.

Shpall mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 10:20.

**Procesmbajtëse,  
Vjosa Hysenaj**

**Kryesues i mbledhjes,  
Enver Rugova**



## Republika e Kosovës

Republika Kosova  
Republic of Kosovo



## Komuna e Istogut

Opština Istok  
Istog Municipality

### KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Lista e e antarve të KKSBB Rr. 27 MPB-03/2012 MPAL  
Lista e nënshkrimeve të anëtarëve dhe pjesmarrësve  
Mbledhja e KKSBB-së me --.---.2022 në ora --.---

| Nr | Institucioni / Subjekti<br>Ime Institucije/Subjekta | Emri Mbiemri<br>Ime i Prezime | Nr telefonit<br>Broj Telefona | E-mail                                                                           | NENSHKRIMI<br>POTPIS |
|----|-----------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| 1. | Kryetari i Komunës                                  | Ilir Ferati                   | 048/688-600                   | <a href="mailto:ilir.ferati@rks-gov.net">ilir.ferati@rks-gov.net</a>             |                      |
| 2. | Policia e Kosovës                                   | Enver Gashi                   | 044/221-554                   | <a href="mailto:enver.gashi@kosovopoliice.com">enver.gashi@kosovopoliice.com</a> |                      |
| 3. | Bashk. Islame                                       | Tahir ef. Bekaj               |                               |                                                                                  |                      |
| 4. | Kisha Katolike                                      |                               |                               |                                                                                  |                      |
| 5. | Kisha Ortodokse                                     | Jerej Nebojša<br>Sekulić      | 049/804 446                   |                                                                                  |                      |
| 6. | Komun Shqipëtar                                     | Zenun Bujupaj                 | 044/276-619                   | <a href="mailto:Zenun.bujupi@hotmail.com">Zenun.bujupi@hotmail.com</a>           |                      |

| Nr  | Institucioni / Subjekti<br>Ime Institucije/Subjekta | Emri Mbiemri<br>Ime i Prezime | Nr telefonit<br>Broj Telefona | E-mail                                                                               | NENSHKRIMI<br>POTPIS |
|-----|-----------------------------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| 7.  | Komun. Serb                                         | Svetlana Đorić                | 045/572-643                   |                                                                                      |                      |
| 8.  | Komun. Boshnjak                                     | Sead Hotović                  | 049/716-514                   | <a href="mailto:djuladjula4@gmail.com">djuladjula4@gmail.com</a>                     |                      |
| 9.  | Komun. Romë                                         | Ganimer Shaqiri-?             | 049/289-264                   | <a href="mailto:gani_shaqiri@hotmail.com">gani_shaqiri@hotmail.com</a>               |                      |
| 10. | Komun. Egjiptas                                     | Ukë Dollci-?                  | 049/243-292                   |                                                                                      |                      |
| 11. | Komiteti për Komunitete                             |                               |                               | <a href="mailto:radenko.belosevic@rks-gov.net">radenko.belosevic@rks-gov.net</a>     |                      |
| 12. | Zyr. Barazi Gjinore                                 | Servete Bujupaj               | 049/766-402                   | <a href="mailto:servete.haxhijaj@rks-gov.net">servete.haxhijaj@rks-gov.net</a>       |                      |
| 13. | Drejt. Drejto. Për Arsim                            | Naim Behlulaj                 |                               | <a href="mailto:naim.behlulaj@rks-gov.net">naim.behlulaj@rks-gov.net</a>             |                      |
| 14. | Kry. Kësh. Të Prindërve të<br>Arsimit të Komunës    | Robert Gegaj-?                | 045/506-040                   | <a href="mailto:robertgegaj@gmail.com">robertgegaj@gmail.com</a>                     |                      |
| 15. | FSK                                                 | Tog. Xhevahir<br>Hasanaj      | 049/902-740                   | <a href="mailto:xhevahir.hasanaj@fsk-rks.org">xhevahir.hasanaj@fsk-rks.org</a>       |                      |
| 16. | KLSP-Gurakoc                                        | Enver Boletini                | 049/766-586                   | <a href="mailto:enverboletini04@gmai.com">enverboletini04@gmai.com</a>               |                      |
| 17. | KLSP-Banjë                                          | Gëzim Ademaj                  | 049/766-421                   | <a href="mailto:gezim.ademaj@rks-gov.net">gezim.ademaj@rks-gov.net</a>               |                      |
| 18. | EVSB                                                | Blendineta Shatri             | 045/425-748                   | <a href="mailto:netashatri@gmail.com">netashatri@gmail.com</a>                       |                      |
| 19. | Spektori I Emergjencave                             | Skender<br>Hasangjekaj        | 049/766-557                   | <a href="mailto:skender.hasangjekaj@rks-gov.net">skender.hasangjekaj@rks-gov.net</a> |                      |
| 20. | Zyra Komunale per<br>Komunitete dhe Kthim           | Enisa Ćorović                 | 049/581-587                   |                                                                                      |                      |

|     | <b>Institucioni / Subjekti<br/>Ime Institucije/Subjekta</b> | <b>Emri Mbiemri<br/>Ime i Prezime</b> | <b>Nr telefonit<br/>Broj Telefona</b> | <b>E-mail</b>                                                                | <b>NENSHKRIMI<br/>POTPIS</b> |
|-----|-------------------------------------------------------------|---------------------------------------|---------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------|------------------------------|
| 21. | OJQ "Liria"                                                 | Asdren Hasanaj -?                     | 044/218-438                           | asdrenhasanaj8@gmail.com                                                     |                              |
| 22. | Radio "Fontana"                                             | Zeqir Mehmetaj                        | 039/450-045<br>044/141-294            | <a href="mailto:radio-fontana@hotmail.com">radio-fontana@hotmail.com</a>     |                              |
| 23. | HANDIKOS                                                    | Lumdita Idrizaj                       | 044/252-400                           | <a href="mailto:Lumdita_idrizaj@hotmail.com">Lumdita_idrizaj@hotmail.com</a> |                              |
| 24. | Komun. i biznesit                                           |                                       |                                       |                                                                              |                              |



|     | <b>Emri i Institucionit /<br/>Subjektit<br/>Ime Institucije/Subjekta</b> | <b>Emri dhe Mbiemri<br/>Ime i Prezime</b> | <b>Nr. Telefonit<br/>Broj Telefona</b> | <b>E-mail</b> | <b>NENSHKRIMI<br/>POTPIS</b> |
|-----|--------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------------------------------------|---------------|------------------------------|
| 1.  |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 2.  |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 3.  |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 4.  |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 5.  |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 6.  |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 7.  |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 8.  |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 9.  |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 10. |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 11. |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |
| 12. |                                                                          |                                           |                                        |               |                              |

\* Antarët e KKSB-së, pjesëmarrës në takim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut  
Skupstina Opstine  
Municipal Istog

Drejtoria Komunale e Arsimit

|                        |                                                |
|------------------------|------------------------------------------------|
| DATË/A:                | 07.03.2022                                     |
| REFERENCE:             | 05.Nr.101/22                                   |
| PËR/ZA/TO:             | Zyrën e Kryetarit z.Illir Ferati               |
| CC:                    | Kryesuesin e Kuvendit z.Enver Rugova           |
| PËRMES/PREKO/THROUGH:  |                                                |
| NGA/OD/FROM:           | Drejtori Komunal i Arsimit,<br>z.Naim Behlulaj |
| TEMA/SUBJEKTA/SUBJECT: | Propozim                                       |



I/e nderuar

Drejtori Komunal i Arsimit duke u bazuar në nenin 6 pika 3.1 të Udhëzimit Administrativ (MASH) Nr. 151/2020, për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të zv.drejtorit të Institucionit Publik, Edukativo –Arsimor dhe Aftësues Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimet ,Përfundimit të Kontratës dhe Emërimet e Përkohshme kërkon nga zyra e Kryetarit të Komunës që ta propozoj në rend dite formimin e komisionit për intervistim të kandidatëve për pozitat drejtor dhe zëvendësdrejtor të Institucioneve Arsimore të Komunës së Istogut.

Komision ka mandat një vjeçar dhe emërohet nga Kuvendi i Komunës ,komisioni sipas UA duhet të ketë përbërje prej dy anëtar të Komunës të cilët propozohen nga DKA dhe një zyrtar addhoc nga MASH-i

Drejtoria Komunale e Arsimit si anëtar të komisionit propozon:

- 1.Naim Sadriu Zyrtar në DKA dhe
- 2.Mimoza Osmanaj-Kabashi Drejtoresh në SHFMU “Martin Camaj” Gurrakoc.

Me respekt!



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVO/ REPUBLIC  
OF KOSOVO



KOMUNA E ISTOGUT/ OPSTINA ISTOK/ MUNICIPALITY OF ISTOG

---

---

**R A P O R T I**  
**I PUNËS JANAR- DHJETOR 2021**

***Mars 2022***

## **PËRMBAJTJA**

1. DREJTORIA PËR INSPEKSION KOMUNAL
2. DREJTORIA E SHËNDETËSISË
3. DREJTORIA E ARSIMIT
4. DREJTORIA BUJQËSI, PYLLTARI DHE HIDROEKONOMI
5. DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA
6. DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM
7. DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR
8. DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS
9. DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE
- 10.KUVENDI I KOMUNËS
- 11.QENDRA PËR SHËRBIM ME QYTETARË

## **Drejtoria për Inspeksion Komunal**

Në përputhje me Planin e Punës për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2021, të Drejtorisë për Inspeksion, në kuadër të sektorëve përkatës, janë realizuar aktivitete inspektuese në terren si dhe veprime administrative në zyrë, me qëllim të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjshmërisë dhe rregulloreve përkatëse komunale.

Sikurse edhe gjatë vitit paraprak, përmes strukturës së Drejtorisë për Inspeksion janë mbuluar këta sektorë, duke përfshirë sektorin e ndërtimit (me 2 pozita inspektoriale), sektorin sanitar (1 pozitë), sektorin e tregut (1 pozitë), sektorin e mjedisit – ambientit (1 pozitë), sektorin e veterinarisë (1 pozitë – e mbuluar përmes kontratës mbi veprën) dhe sektorin e komunikacionit (1 pozitë – e mbuluar përmes kontratës mbi veprën)

Gjatë periudhës raportuese, si rezultat i aktiviteteve inspektuese të realizuara në vazhdimësi në terren, janë arritur rezultate konkrete në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjshmërisë, siç është prezantuar në të dhënat vijuese, e që kanë të bëjnë me:

**Ruajtjen e brezit mbrojtës të rrugëve regjionale dhe lokale, në territorin e Komunës me ç’rast janë:**

- hartuar 116 procesverbale.
- janë lëshuar 24 aktvendime .
- 22 rrethime të objekteve.
- 37 ri- inspektime
- 2 pezullime të lejes së ndërtimit.
- 12 përgjigje në bazë të kërkesës së palës.
- 4 lëndë të proceduara në gjykatë.
- 9 gjoba mandatare

**Punët e Inspektorit të Ndërtimit - Zona Urbane.** Punët e Inspektorit të Ndërtimit për periudhën raportuese janë zhvilluar në bazë të planit të punës Janar –Dhjetor 2021 të Zyrës së Inspeksionit dhe planit operacional të hartuar nga bartësi i pozitës. Aktiviteti inspektues ka qenë i fokusuar dhe i mbështetur në bazë të kompetencave të akteve ligjore në fuqi për pozitën e punës së lartë shënuar dhe ka qenë i fokusuar në : **Inspektime për mbikëqyrje të zbatimit të dispozitave të Ligjit Ndërtimit**". Aktiviteti kryesor i Inspektorit të Ndërtimit ishte parandalimi i ndërtimeve jolegale , kontrollimi, evidentimi , incizimi dhe ndërmarrja e hapave konkret si në parandalim ashtu edhe në ndjekjen e procedurave ligjore për objektet e ndërtuara si në pronë private ashtu edhe në pronë publike. Aktiviteti i shtuar i Inspektorit të ndërtimit ka rezultuar me ndaljen e ndërtimeve pa leje, me theks të veçantë në pjesët urbane të qytetit. Këto masa të inspektorit kanë ndikuar që të shtohen kërkesat për leje ndërtimore dhe legalizim të objekteve banesore dhe afariste.

Ku gjatë këtyre inspektimeve në teren nga ana e inspektorit të ndërtimit në katër qendrat urbane Istog, Gurakoc, Banjë dhe Vrellë janë bërë 80 inspektime dhe 42 riinspektime , 75 procesverbale , 15 aktvendime , 7 gjoba mandatare.

Me aktvendim u është ndërprerë puna 15 objekteve të ndërtimit dhe atë:

Istog.....8  
Banjë.....3  
Gurakoc...2  
Vrellë .....2

Kemi pranuar 35 kërkesa nga investitorët dhe punë kryesit e punimeve të objekteve për të bërë inspektimin dhe protokollin mbi përfundimin e të gjitha fazave gjatë ndërtimit siç parashihet me ligj të ndërtimit. Njoftim për Policinë e Kosovës, stacioni policor në Istog për asistencë në ndërprerjen e punimeve për 1 objekt. Po ashtu me 2 kërkesa u jam drejtuar : Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi për dalje të gjeodetëve në teren për incizim të objekteve .

**Mbikëqyrjen e kushteve higjieniko-sanitare** në sektorin e shëndetësisë ,tregtisë, hotelerisë,arsimit, gjatë kësaj periudhe raportuese **me ç’rast janë:**

- Hartuar 1364 vendime për izolim nga Covit 19.
- Janë hartuar 1553 vendime për lirim nga izolimi nga Covit -19
- Janë lëshuar 13 pëlqime sanitare.
- Janë hartuar 20 procesverbale – kontrolla rutinore në gastronomi.
- Janë hartuar 10 procesverbale – inspektim në sallonet e ondulimit.
- Janë hartuar 6 procesverbale për tejkalim të orarit të punës.
- Janë lëshuar 5 gjoba mandatare për tejkalim të orarit të punës në gastronomi.
- 5 gjoba për për mos respektimin e Ligjit Kundër Pirjes së Duhanit
- Janë hartuar 5 procesverbale për largimin e shitësve ambulantor.
- Është hartuar 1 procesverbal për mbyllje lokali.
- Janë hartuar 2 procesverbale për heqje ndalese.
- Janë hartuar 2 procesverbale për asgjësimin e mallit me afat të skaduar.

**Mbikëqyrjen e fushës së tregtimit**, qarkullimit dhe ekspozimit të mallrave dhe të shërbimeve, si dhe ligjshmërisë së funksionimit të veprimtarive të tilla biznesore janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë lëshuar 5 pëlqime tregtare.
- Janë hartuar 20 procesverbale – kontrolla rutinore ne gastronomi.

- Janë hartuar 10 procesverbale – inspektim në sallonet e ondulimit.
- Janë hartuar 6 procesverbale për tejkallim të orarit të punës.
- Janë lëshuar 5 gjoba mandatare për tejkallim të orarit të punës në gastronomi.
- 5 gjoba për mos respektimin e Ligjit Kundër Pirjes së Duhanit
- Janë hartuar 5 procesverbale për largimin e shitësve ambulantor.
- Është hartuar 1 procesverbal për mbyllje lokali.
- Janë hartuar 2 procesverbale për heqje ndalese.
- Janë hartuar 2 procesverbale për asgjësimin e mallit me afat të skaduar.

**Në sektorin e mbrojtjes së mjedisit - ambientit,** raporti është hartuar për periudhën Janar-Qershor 2021, pasi që Inspektori i Ambientit nga 01.07.2021 ka kaluar në detyrë të re. Gjatë kësaj periudhe raportuese janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë hartuar **51** procesverbale inspektuese .
- Janë lëshuar 2 Aktvendime.
- Janë shqyrtuar 5 kërkesa të palëve të cilat kanë marrë zgjidhje.
- Janë lëshuar 6 gjoba mandatare.
- 4 shkresa drejtuar palëve dhe institucioneve të ndryshme .
- 4 lëndë janë në procedurë përmbarimore.

**Sektorin e veterinarisë:** Gjatë periudhës raportuese inspektori i veterinarisë ka kryer punët në bazë të ligjeve respektive në fuqi dhe të kontratës me Komunën e Istogut për shërbimet e mëposhtme: Aktivitetet lidhur me therjen, shitjen dhe qarkullimin e mishit; me ç'rast janë realizuar 684 vizita-inspektime të therjes dhe vulosjes së mishit.

- 2 Inspektime të tregut kafshëve.
- 9 Inspektime të hurdhave të peshkut.
- 19 Procesverbale me rastin e sëmundjes dhe ngordhjes të kafshëve dhe shpezëve.
- 23 Procesverbale të hartuara si pasojë e dëmtimit dhe mbytjes së kafshëve nga ujku, ariu dhe procesverbalet e hartuara me kërkesën e palës.
- 1 Procesverbal, konfiskimi dhe asgjësimi i mishit .
- 1 Procesverbal mbytja e ariut.
- 1 Procesverbal mbytja e kafshëve nga rrufeja.
- 6 Procesverbale , vdekja dhe dëmtimi i bletës.

## **Në sektorin e komunikacionit**

Aktiviteti inspektues ka qenë i fokusuar dhe i mbështetur në bazë të Ligjit Nr. 04/L-179 Për Transportin Rrugor , Rregullores Komunale Nr. 5/2014 dhe kompetencave të përshkruara në bazë të marrëveshjes për shërbimet e veçanta . Në bazë të kompetencave të lartcekura Inspektori i Komunikacionit ka paraqitur këtë raport të aktiviteteve të kryera . 64 Inspektime të operatorëve ekonomik të transportit publik të udhëtarëve me autobus në territorin e komunës së Istogut. 90 Inspektime të operatoreve të transportit me auto-taxi ne territorin e komunës se Istogut. Krahas punëve dhe obligimeve të planifikuara, në periudhën Janar – Dhjetor2021, kësaj Drejtorie i janë parashtruar edhe kërkesa tjera për realizimin e aktiviteteve të ndryshme inspektuese në terren të cilat kanë marrë përgjigje brenda afatit të paraparë ligjor.



## DREJTORIA E SHËNDETËSISË

Shëndetësia paraqet një segment të rëndësishëm për Komunën dhe si e tillë gjatë kësaj periudhe e terë puna dhe veprimtaria e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale ka qenë e drejtuar në përmirësimin dhe në ngritjen e cilësisë dhe disiplinës në kryerjen e shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës së Istogut. Rëndësi e veçantë i është kushtuar sidomos zbatimit të reformave në lëmin e Mjekësisë Familjare, përmirësimit të kushteve të punës dhe të infrastrukturës në objektet shëndetësore.

**Plani i punës** - Gjatë kësaj periudhe fillimisht është bërë Plani i punës për vitin 2021, në të cilin janë përcaktuar detyrat dhe objektivat që ky drejtorat ka planifikuar t'i realizojë gjatë kësaj periudhe. Është bërë Plani i shpenzimeve të fondeve të alokuara në katër nënprograme buxhetore të cilat i menaxhon Drejtorati për Shëndetësi (administrata shëndetësi-(73026), Shërbimet e Shëndetit Primar-(74000), Shërbimet Sociale-(75581) dhe Shërbimet Rezidenciale- (75582).

**Shqyrtimi i kërkesave**- Gjatë kësaj periudhe, këtij drejtorati i janë parashtruar një numër i madh i kërkesave të cilat kanë të bëjnë me kërkesat për ndihmë financiare për shërim dhe blerje të medikamenteve, për këtë qëllim janë ndarë **10,000.00€** dhe kanë përfituar mbi 102 individ , pastaj kemi pas edhe një numër të madh të kërkesave për kompensimin e shpenzimeve të karburanteve për personat të cilët janë në Hemo-dializë, dhe kanë nevojë për përcjellës të cilët si mjet transporti përdorin automjetet private, pastaj për personat të cilët trajtohen me kimio-terapi dhe rrezatim në SHSKUK. Për grupin e parë kemi ndarë nga 57 lit. karburant në muaj ndërsa për grupin e dytë nga 10 lit. karburant për një relacion Istog-Prishtinë dhe anasjelltas. Për këto dy qëllime deri me tani janë dhenë **11500 lit.** Karburant.

Me paraqitjen e Pandemisë nga Virusi Covid-19 në mars të vitit të 2020, drejtorati i shëndetësisë i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për parandalimin dhe luftimin e kësaj pandemie sipas rekomandimeve të IKSHPK. Është formuar shtabi emergjent për luftimin e pandemisë me në krye z. Haki Rugova, kryetar i komunës. Janë formuar ekipe mjekësore të posaçme të cilat kanë bërë vizita sistematike në shtëpia për t'ju dalë në ndihmë qytetarëve të cilët janë prekur nga ky virus.

**Realizimi i Projekteve** - Sa i përket projekteve, në këtë vit kemi realizuar këto projekte:

1.**Blerja e Pajisjeve Mjekësore**; përmes këtij projekti janë blerë pajisje të ndryshme Mjekësore me vlerë rreth 20,000.00€.

2. **Ndërtimi i ambulancës në Fshatin Uçë**. Ky objekt është ndërtuar në një lokacion të ri nga themeli. Ndërtimi i këtij Objekti ka kushtuar rreth 39,000.00€

3. **Ndërtimi i rrethojës në ambulancën e fshatit Cerkolez**, ky projekt është përfunduar dhe vlera e këtij projekti ka qenë rreth 19,000.00€

4. **Pajisje të ndryshme të teknikës së bardhë**. Përmes këtij projekti janë blerë pajisje të teknikës së bardhë për nevoja të QKMF -së dhe shtëpisë së komuniteteve në Gjurakoc 7,000.00€. Projekti i paraparë për blerjen e dy automjeteve (gjip për nevoja të shërbimeve sociale dhe automjet për nevoja të drejtoratit për shëndetësi) me vlerë të parashikuar prej 45,000.00€, nuk është realizuar për shkak se i njëjti dy herë radhazi është tenderuar dhe nuk është paraqit asnjë ofertues. Edhe në këtë vit kemi vazhduar me projektin me bashkëfinancim të Komunës së Istogut dhe Caritas Kosova me titull “**Përkujdesja Shëndetësore Shtëpiake dhe Ambulator -Home Care 2020**” i cili realizohet me vizita sistematike në shtëpi për personat dhe familjet me nevojë. Implementues i këtij projekti është Caritas Kosova dhe zgjat nga 01.01.2021 deri me 31.12.2021. Vlera e këtij projekti është **110,000.00€**. Caritas Kosova, do të participoj në këtë projekt me pajisje, Infrastrukturë menaxhuese, pajisje shëndetësore në vlerë prej **18,000.00 €**, Komuna e Istogut do të participoj në vlerë monetare shumë prej **92,000.00€ dhe** Përmes këtij projekti kemi realizuar punësimin e 25 punëtorëve kryesisht staf shëndetësorë. Përmes këtij projekti gjatë këtij viti janë realizuar qindra vizita shtëpiake duke ju ofruar shërbime të ndryshme mjekësore për njerëzit me nevojë.

### **QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE -ISTOG**

**Vizita mjekësore**, Në QKMF, QMF dhe AMF janë kryer 72476 vizita mjekësore, shërbimi i stomatologjisë 3755 shërbime, laborator 25975 shërbime laboratorike, radiologji 7460 shërbime radiologjike.

**Numri i shërbimeve** Infermierore, duke përfshirë dhënia e terapisë paranterale, lidhje pastrim plage etj gjithsejtë janë kryer 347561 shërbime.

**Numri i vizitave shtëpiake**, Nga ekipi mjekësorë mjek, infermier si dhënia e terapisë intravenoze, vendosja e kateterit si dhe shërbime tjera janë kryer 1862 shërbime .

**Vizita mjekësore nga Shëndeti mendorë**, ekipi i Shëndetit Mendorë -Pejë mjek -infermier kanë kryer vizita mjekësore për 251 klient si dhe trajtimi me terapi muskulare si me moditen depo 68 amp dhe amp. Haldol depo 175 amp.

**Vazhdimi me plan-programin e ZHVP-së për Infermier:**

Nuk është realizuar plani për shkak të pandemisë.

### **Furnizimi me terapi:**

Gjatë vitit 2021 furnizimi me barna dhe material shpenzues nga Lista Esenciale (LE) ka qenë relativisht e mirë ( po ashtu mirë të furnizuar kemi qenë edhe me material mbrojtës -anti covid ), mungesat nga Lista Esenciale janë përmbushur nga Drejtoria për

Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Kështu që furnizimi me barna, material shpenzues dhe material mbrojtës ka qenë i mirë .

### **Vaksinimi**

Vaksina dhe shërbime në shërbimin e vaksinimit në QKMF – Istog gjatë vitit 2000

|                             |       |
|-----------------------------|-------|
| Vaksina total të aplikuara  | 11033 |
| Shërbime në vaksinim        | 21393 |
| <b>Vaksina antiCovid-19</b> |       |
| Doza e parë                 | 20267 |
| Doza e dytë                 | 16044 |
| Doza e tretë                | 2326  |

Vaksinat e gripit sezonal janë marrë 3492 doza :

### **Hemodializa**

Transport i pacientëve për Hemodializë në Spitalin Rajonal –Pejë është bërë 3 here në javë . Numri i pacientëve që janë transportuar për nevoja të hemodializës gjatë kësaj periudhe ka qenë 11 pacientë.

### **Maternitet dhe gjinekologji**

Gjatë kësaj periudhe në Maternitetin e QKMF –Istog janë kryer 14 lindje. Vizita shtëpiake për nëna dhe fëmijë janë kryer 247 vizita. Vizita gjinekologjike kanë kryer 195 pacient.

### **Kujdesi Shtëpiak –Caritas Kosova**

Kujdesi në shtëpi është përcaktuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë si "aftësia për të ofruar në shtëpinë e pacientit ato shërbime dhe mjete që kontribuojnë në ruajtjen e nivelit më të lartë të mirëqenies, shëndetit dhe funksionit jetik. Shërbimi Mjekësor në Shtëpi është një grup i koordinuar i veprimtarisë shëndetësore, me ndërhyrjet e duhura drejtuar mirëqenies sociale, shëndetit, rehabilitimit dhe për të ndihmuar personin e sëmurë në shtëpi. Synimi kryesor i këtij projekti është se duke u bazuar në modelet e përvojat me të suksesshme , kujdesi në shtëpi është kujdes që lejon përfituesin të qëndrojë në shtëpi dhe të përfitoj nga marria e shërbimeve. Home-Care Istog ka pasur mbështetje të vazhdueshme nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, janë siguruar vizitat në teren nga Mjekët,. për përfituesit e projektit, është bërë sigurimi i medikamenteve esenciale nga barnatorja qendrore e QKMF së Istog, sigurimi i gazave, instrumenteve sterile, sigurimi i kateterave , qesëve për stomë etj.

## SHËRBIMET SOCIALE

Aktiviteti i këtij shërbimi bazohet ne Ligjin për Skemën e Ndhimave Sociale (SNS) në Kosovë Nr. 2003/15, Rregullores Zbatuese Nr. 2003/XX mbi zbatimin e ligjit dhe Udhëzimit administrative Nr. 06/2005 për Rregullimin e procedurave të përkrahjes, si dhe Ligjin Nr.04/L-096 për Ndryshimin dhe plotësimin e ligjit 2003/15 të Skemës së Ndhimës Sociale në Kosovë Ky shërbim është i përberë nga udhëheqësi i Ndhimave sociale dhe katër nëpunës, lëndët e të cilëve janë ndarë proporcionalisht me teren – fshatrat për nëpunës, ndërsa Baza e të Dhënave udhëhiqet nga udhëheqësi i sektorit të Ndhimave Sociale. Udhëheqësi i Ndhimave sociale çdo ditë benë organizimin e punëve me nëpunësit sipas prioriteteve, mban takime të rregullta javore në rast nevojë edhe ditore me drejtorin dhe udhëheqësit e dy shërbimeve për planifikimin dhe përcaktimin e prioriteteve në punë, si dhe mban takime javore me nëpunësit e SNS-së. Përzgjedhja e përfituesve të Ndhimave Sociale bëhet sipas kriterëve të parapara në këtë ligj, identifikimit dhe verifikimit të gjendjes së familjeve të cilat janë në nevojë sociale. Gjatë periudhës vjetore 2021 në këtë shërbim mesatarja e shfrytëzuesve të Ndhimave Sociale është 471 familje me 1920 anëtar, mesatarja në kategorinë e parë 231 familje me 880 anëtar dhe mestarja në kategorinë e dytë 240 familje me 1040 anëtar.

### Aplikacionet e reja

Gjatë periudhës raportuese numri i aplikacioneve të reja ka qenë 121 aplikacione: 93 aplikacione të kategorisë së II-të dhe 28 të kategorisë së parë, prej tyre: 96 lëndë kanë qenë të pranuar ndërsa 25 lëndë kanë qenë të refuzuara. Në këtë shërbim shfrytëzues të Ndhimave Sociale janë edhe minoritetet nga të cilat: 65 familje egjiptiane, 18 familje ashkali, 04 familje rome, 03 serbe, 01 malazeze 04 familje boshnjake si e dhe 13 të tjerë, të cilët nuk janë deklaruar por janë nga minoritetet pakicë e të cilat janë të shpërndarë nëpër fshatrat të komunës së Istogut dhe mbulohen me teren nga nëpunësit e Ndhimave Sociale të QPS-së. Këtu vlen të theksohet se numri minoriteteve është trajtuar në mënyrën më të mirë të mundshme dhe kanë pasur trajtim të barabartë si dhe qasje normale në institucionin tonë dhe i kanë gëzuar të gjitha të drejtat e parapara me ligjet në fuqi. Numri i familjeve të ri-aplikuara. Gjatë periudhës raportuese janë ri-aplikuar gjithësejt 1147 lëndë ku prej tyre 467 kanë qenë të kategorisë së parë si dhe 680 lëndë të kategorisë së dytë. Nga këto 1027 lëndë kanë qenë të aprovuara si dhe 130 lëndë të ndërprera.

### Lëshuarje e vendimeve

Gjatë periudhës raportuese vjetore për vitin 2021 janë lëshuar gjithësejt 1147 vendime, nga këto 1292 vendime kanë qenë pozitive si dhe 129 vendime negative.

Mbajtja e komisioneve mjekësore Janë mbajtur gjithësejt njëmbëdhjetë seanca te komisionit regional mjekësor ku këtij komisioni ju kanë nënshtruar 374 lëndë dhe nga këto lëndë ka rezultuar si vijon: 282 lëndë kanë pasur vlerësim pozitiv, 81 vlerësim negativ si dhe 11 lëndë në rishqyrtim. Janë lëshuar 470 vërtetime për klientët ku nga këto: 36 vërtetime kanë qenë për klient të qe kane qenë shfrytëzues te SNS, 23 për ata klient që nuk kanë qenë shfrytëzuese të SNS-së, si dhe 83 vërtetime për aplikim për marrjen e Shtetësisë së Kosovës . Në bashkëpunim me UNDP-in kemi përpiluar listën prej 58 familjeve si dhe ju është bërë shpërndarja e vauqerave (banave. Familjet kanë përfituar ushqim dhe mjete higjienike për gjashtë (6) muaj.

### SHËRBIMET REZIDENCIALE

1. Strehimi në shtëpitë për mbrojtën e viktimave të dhunës në familje..... 6
2. Strehimi në shtëpitë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit.....
3. Vendosja në institucione të mbrojtjes sociale..... 0
4. Të trajtuarit e shëndetit mendor të kategorive të ndryshme 0
5. Shërbimet për persona te rritur, viktimat të trafikimit
6. Shërbimet për personat e rritur, viktimat të krimeve seksuale
7. Tentim vetëvrasje.....

### SHERBIME FAMILJARE

1. Fëmijët e braktisur..... 0
2. Fëmijët me sjellje asociale..... 0
3. Abuzimi seksual i të miturve.....0
4. Kujdestaria për të mitur..... 1
5. Kujdestaria për të rritur..... 6
6. Bashkim familjar.....
7. Birësimi me element vendor (familja adoptuese)..... 1
8. Birësimi me element ndërkombëtar ( familja adoptuese )..... 0
9. Strehimi në familje farefisnore ..... 1
10. Strehimi në familje alternative..... 1
11. Strehimet për rehabilitim e reintegrim të viktimave në familje e komunitet
12. Dhënia e këshillave familjare..... . 78
13. Ndihma në rregullimin e marrëdhënieve bashkëshortore e familjare.. . 55
14. Dhënia e mendimit për besimin e fëmijëve..... 13
15. Dhënia e mendimit për martesat e miturve..... 2
16. Personat me nevojë të veçanta..... 3
17. Ndihma për realizimin e kontaktimit mes fëmijëve e prindërve të ndarë – shkurorëzuar..... 6
18. Shërbimet për fëmijët e rrëmbyer me element vendor..... 0

|                                                                |   |
|----------------------------------------------------------------|---|
| 19. Shërbimet për personat e rritur përdorues të alkoolit..... |   |
| 20. Shërbimet për personat e rritur përdorues të drogës .....  |   |
| 21. Fëmijët me aftësi të kufizuara.....                        | 7 |

#### SHËRBIMET E KOMUNITETIT

|                          |   |
|--------------------------|---|
| 1. Fëmijët në punë ..... | 0 |
|--------------------------|---|

#### SHËRBIMET E KRIMEVE PER GJYKATE

|                                                                  |    |
|------------------------------------------------------------------|----|
| 1. Shërbimet për fëmijët në konflikt me ligjin (delikuenca)..... | 18 |
|------------------------------------------------------------------|----|

#### SHERBIME ADIMINISTRATIVE

|                                                                                     |     |
|-------------------------------------------------------------------------------------|-----|
| 1. Certifikatë /Dëshmi që pala nuk ka obligime financiare ndaj personave fizik..... | 171 |
| 2. Pëlqimi për dokument të udhëtimit .....                                          | 2   |
| 3. Regjistrimi i mëvonshëm i fëmijëve .....                                         | 1   |
| 4. Certifikatë se nuk i është marr aftësia e veprimit .....                         | 312 |
| 5. Pëlqimi për bartje të pasurisë.....                                              | 0   |
| 6. Konstatime zyrtare.....                                                          | 5   |

#### SHTËPIA PËR KOMUNITETE NË GJURAKOC

Në Shtëpinë e komuniteteve në Gjurakoc në vitin 2021 kanë qenë të të vendosur 17 rezident nga të cilët: Komuna e Istogut 1 rezident, komuna e Pejës 6, komuna e Gjakovës 1 komuna e Deçanit 3, nga komuna e Klinës 5, komuna e Junikut 1 .Nga numri i përgjithshëm i të vendosurve, 15 janë të nacionalitetit shqiptarë, një i komunitetit Rom dhe një i komunitetit Boshnjak.

## DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

Drejtoria Komunale e Arsimit, kryen detyrat dhe obligimet në përputhje me Ligjin për Arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-032, Ligjin Për Arsim në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Ligjin për Arsimin dhe aftësimin Profesional Nr. 02 L-42, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve nr. 02/L-24, Ligjin për Arsimin Parashkollor nga MASHTI, dhe UA të MASHTI-it që përcaktojnë përgjegjësit e Komunitetit për organizimin e procesit edukativo-arsimor në të gjitha nivelet si dhe aktet tjera komunale. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Në mbështetje të nenit 5 paragrafit 2 nënparagrafi 2.1 të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (Gazeta zyrtare nr. 17, 16 shtator 2011), nenit 8, paragrafit 1, shtojcës 1 pikës 7 të Rregullores (QRK) nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe Udhëzimit administrativ nr. 03/2013 për standardet e hartimit të akteve normative (GZ, nr. 03/2013, dt. 16.05.2013), nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV(MASHTI) NR. 7 / 2021 PËR KALENDARIN E VITIT SHKOLLOR 2021/2022

Viti shkollor 2021/2022, do të fillojë me 1 shtator 2021 dhe do të përfundojë me 31 gusht 2022.

Perioda e parë, fillon me 1 shtator 2021 dhe përfundon me 24 dhjetor 2021.

Perioda e dytë, fillon me 10 janar 2022 dhe përfundon me 01 prill 2022.

Perioda e tretë fillon me 12 prill 2022 dhe përfundon me: 13 maj 2022, për nxënësit të cilët e përfundojnë shkollën e mesme të lartë klasën e 12-të (maturantët). 3 qershor 2022, për nxënësit e klasave 9, 10 dhe 11-të dhe 17 qershor 2022, për nxënësit e klasave 1-8 dhe fëmijët parafillor

Viti shkollor 2021/22 filloi në kushte të pandemisë COVID19, andaj me vendim të MASHTI-t mësimi ka filluar me 14 shtator 2022, për ditët e humbura nga MASHTI është nxjerr vendim me nr. 01/B/292 i datës 28.09.2021 për kompensimin e orëve të humbura. Organizimi i punës udhëhiqet dhe menaxhohet nga DKA-ja, drejtorët e shkollave dhe stafi profesional, prindër dhe nxënës, përmes organeve udhëheqëse të shkollës në bashkëpunim të vazhdueshëm me aktorët tjerë si MASHTI dhe Sektorin e Inspektoratit për Arsim gjithnjë duke respektuar Ligjin e Arsimit parauniversitar si dhe udhëzimet e lartcekura. Arsimit në komunën e Istogut vazhdon të jetë e organizuar dhe në funksion të ruajtjes së standardeve model të kërkuara nga MASHTI duke synuar trendet e nevojshme krahas zhvillimit të shoqërisë me tendencë të plotësimit të nevojave shoqërore. Në pjesën e parë të vitit 2021 Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit është organizuar në vlerësimin e cilësisë së teksteve duke u shtrirë në nivel të mësimdhënësve në kuadër të fushave për të dhënë mendimin e tyre duke krijuar debat edhe brenda institucioneve për tekstet shkollore sepse mbetet sfida e deritanishme harmonizimi i teksteve dhe kurrikulave lëndore që janë derivat i Kornizës së Kurrikulës së Kosovës dhe kurrikulave bërthamë, vlen të

ceket se për vitin shkollor 2021/22 kemi pas mundësi përzgjedhje te teksteve alternative nga disa shtëpi botuese. Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, bazuar në vendimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës ka ndërmarr të gjitha masat që viti shkollor 2021/22 të filloi sipas normave të përcaktuara në këto vendime dhe udhëzime, andaj kemi filluar me skenarin e **Rikthimit**. Strukturat e parapara për adresimin e çështjeve sipas vendimeve dhe udhëzimeve të MASH-it kanë funksionuar në të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar e po ashtu edhe ne nivel komunal. Zhvillimi profesional i mësimdhënësve gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bazuar në ofertën e MASH-it, ofertuesve tjerë dhe në të gjitha rastet është menaxhuar mirë nga DKA-ja dhe adresimi ka qenë aspekti profesional i mësimdhënies dhe të nxënësve si dhe sjellja në kushtet e pandemisë dhe përdorimi i teknologjisë dhe qasja në platformat e mundshme për komunikim.

Numri i institucioneve edukative e arsimore duke përfshirë edhe numrin e nxënësve në institucionet edukative dhe arsimore në Komunën e Istogut është:

- ❖ Pesë kopshte - fëmijët një deri në nivelin para fillor,
- ❖ Njëmbëdhjetë institucione - niveli para fillor, fillor dhe mesëm i ultë,
- ❖ Dy institucione - niveli mesëm i lartë

Numri i fëmijëve dhe nxënësve sipas niveleve në fillim të vitit shkollor në Komunën e Istogut është:

- Në fillim të vitit shkollor 2020/21 është 6893 gjithsej.
- Në fillim të vitit shkollor 2021/22 është 6726 gjithsej.

Në vitin shkollor 2021/22 numri i nxënësve është zvogëluar për 167 nxënës në raport me numrin e nxënësve në fillim të vitit shkollor 2020/21. Drejtoria Komunale e Arsimit në vitin 2021 në bashkëpunim me drejtorët e shkollave dhe akteret tjerë institucional lokal dhe qendror , organizoi dhe monitoroi procesin mësimor i cili është organizuar në bazë të obligimeve që dalin nga politikat qendrore e lokale të bazuara në planet, strategjitë dhe protokollet e aprovuara me qëllim të përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së shkollës në kontest të rritjes së cilësisë në arsim. Edhe këtë vit ky proces ishte i sfiduar për shkak të pandemisë dhe situata e pandemisë vazhdon ende, angazhimi ishte dhe vazhdon të jetë i gjithanshëm për të eliminuar sfidat e involvuar standardeve të aplikuara nga institucionet relevante kompetente duke inkorporuar konsulencën profesionale edhe të institucioneve të shëndetit publik për të rritur sigurinë dhe qëndrueshmërinë/kompetencën për menaxhim dhe udhëheqje në kushte të pandemisë në të gjitha aspektet e organizimit dhe nivelet e komunikimit dhe vendimmarrjes, organizimi në aspektin e normave, aspektin teknik, teknologjikë e psikologjikë. Organizimi i punës udhëhiqet dhe menaxhohet nga DKA-ja, drejtorët e shkollave dhe stafi profesional, prindër dhe nxënës, përmes organeve udhëheqëse të shkollës në bashkëpunim të vazhdueshëm me akteret tjerë si MASHT dhe Sektorin e Inspektoratit për Arsim. Arsimi në komunën e Istogut vazhdon të jetë e organizuar dhe në funksion të ruajtjes së standardeve model të kërkuara nga MASH duke synuar trendet e nevojshme krahas zhvillimit të shoqërisë me tendencë të determinizmit të nevojave shoqërore. Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Ministrinë e



Arsimit është organizuar në vlerësimin e cilësisë së teksteve duke u shtrirë në nivel të mësimdhënësve në kuadër të fushave për të dhëne mendimin e tyre duke krijuar debat edhe brenda institucioneve për tekstet shkollore sepse mbetet sfida e deritanishme harmonizimi i teksteve dhe kurrikulave lëndore që janë derivat i Kornizës së kurrikulës së Kosovës dhe kurrikulave bërthamë. Viti 2021 ishte po ashtu një vit me prezencën e pandemisë COVID19, sistemi i arsimit edhe në komunën e Istogut u gjend para një sfide të madhe. Mësimi objektet e institucioneve shkollore të komunës së Istogut, varësisht nga nr. i nxënësve të infektuar dhe mësimdhënësve punoj dhe në harmoni me rekomandimet e Ministrisë së Arsimit u organizua për të zhvilluar procesin mësimor përmes platformave Online të komunikimit, skenarit A, C por më shumë mësimi është mbajtur sipas skenarit të Ri-kthimit. DKA, është organizuar për të nxjerr informata përmes raportimit ditor, javor apo sipas nevojë nga shkollat për ecurinë e përmbushjes së obligimeve të mësimdhënësve në mësimdhënës dhe pjesëmarrjen e nxënësve në proces edukativ e arsimor dhe duke përcjellë të dhënat në Zyrën Regjionale të Arsimit edhe në Ministrinë e Arsimit dhe njëkohësisht bazuar në këto raporte kemi analizuar gjendjen duke ndërmarr hapa përkrahës sipas nevojës. Drejtoria Komunale e Arsimit, analizon mbi bazën e parimeve dhe kriterëve për vlerësimin e brendshëm të institucioneve të Arsimit para universitar në kontest analitik vlerëson kahet e zhvillimit të arsimit dhe bazuar në nevoja dhe kapacitete materiale e humane orienton përparësitë dhe aplikon indikatorët që kanalizojnë orientimet programore në sigurimin të cilësisë. Parimet e vlerësimit në sistemin e arsimit bazuar në kornizën për sigurimin e cilësisë janë:

- ❖ Menaxhimi dhe udhëheqja,
- ❖ Kultura dhe mjedisi shkollor
- ❖ Mësimdhënia dhe të nxënit,
- ❖ Zhvillimi profesional i mësimdhënësve,
- ❖ Përformanca e nxënësve.

### **Tri objektivat prioritare të komunës për parimin gjithë përfshirjes:**

1. Identifikimi dhe Integrimi i fëmijëve jashtë shkollës përmes identifikimit me bashkëpunim të zyrave relevante, përmes ekipeve shkollore për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit të nxënësve në shkolla dhe komunitetit në afërsi të shkollës dhe prindërve
2. Funkcionalizimi i ekipeve shkollore përmes krijimit të planeve të veprimit dhe menaxhimit të rasteve të identifikuar dhe raportimit – adresimi të institucionet përgjegjëse siç është DKA-ja.
3. Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuar përmes përmirësimit të ambientit shkollorë, ambientit të mësimi dhe sigurimit të personelit adekuat dhe të mjaftueshëm.

Drejtoria Komunale e Arsimit bashkë me shkollat është e angazhuar në procesin e parandalimit braktisjes dhe mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla ne kemi analizuar nevojat dhe ju kemi përgjigjur kërkesave për vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe kjo ka qenë kompetencë e ekipit komunal për vlerësim pedagogjik i cili ju është përgjigjur çdo kërkesë që është iniciuar duke vlerësuar dhe analizuar çështjet me rekomandime për kompetentet. Sfidë për DKA-në mbetet përfshirja në sistemin e arsimit e të gjithë fëmijëve e ne veçanti atyre me nevoja të veçanta bazuar në punën e ekipit për komunal për vlerësim pedagogjik nevojitet numër shumë me i madhe e asistenteve dhe mësime të mbështetës për fëmijë me nevoja te veçanta krahasuar me kuotën e përcaktuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe duhet shikuar mundësia që për vitin e ardhshëm 2022/23 të definohet ky proces në mes Ministrisë dhe Komunës sepse gjithë përfshirja është një nga parimet fundamentale ne arsim dhe po ashtu është pjesë e gjitha dokumenteve strategjike dhe akteve normative për arsimin para universitar në Republikën e Kosovës.

### **Zhvillimi Profesional i Mësime të**

Drejtoria Komunale e Arsimit ka vazhduar me organizimin i trajnimeve me qëllim të ngritjes së kapaciteteve në mësime dhe në të nxënë. Drejtoria Arsimore në bashkëpunim me MASHT-in,ka organizuar trajnimin për Udhëheqje Arsimore,,trajnimi i edukatoreve të nivelit para fillor,Menaxhimi i stresit të nxënësit,pas pandemisë Covid 19, Bazat e mico –bit-it-kodimi,trajnimi për fasilitator /trajner,shëndeti riprodhues,si dhe janë organizuar sesione informuese për testin PIRLS për testin e maturës.

### **Projektet kapitale**

Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Ministrin e Arsimit Shkencës është e angazhuar në përmbylljen politikave të përmirësimit të infrastrukturës shkollore dhe në këtë funksion ka përfunduar- Ndërtimi i çerdhes së fëmijëve në Vrellë, Pritet që në vitin 2022 të përfundojnë edhe projektet tjera te cilat janë të financuara nga MASHT-i,si:çerdhes së re në Istog, shkollës „Tre Dëshmoret e Shkollës Shqipe” në Uçë , shkollës „Fan S. Noli” në Llukac të Begut , palestrës sportive në shkollën „Martin Camaj” në Gurakoc, palestrës sportive në shkollën „Hysni Zajmi”. Financuar nga MASHT-i,është bërë Furnizimi me pajisje për kabinet te fizikes,kimisë dhe matematikës shkolla fillore “Bajram Curri”-Istog,në vlerë prej 48 000 euro. Ndërsa nga Buxheti komunal janë realizuar këto:

- Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës në sh.f.Martin Camaj-paralelja e ndarë në Serbobran-----vlëra -- 21 865.75 €
- Renovimi i objektit shkollor dhe infrastrukturës në sh.f.mu “Fan Noli”-paralelja e ndarë në Dobrushë-----vlëra---- 19 427.00€
- Renovimi i dysHEMEVE ne Gjimnazin Haxhi Zeka-Istog----- vlëra-----16 666.66€

-Ndërtimi i depove për dru ne 3 shkolla, Rakosh,Dubrave dhe Uçë----vlëra---14 770.60 €  
 -Ndërrimi i dyerve dhe dritareve ne shkollën "Hysni Zajmi"-Vrellë----vlëra-----4 808.00€,  
 -Furnizimi dhe instalimi i nxehtësisë qendrore ne shkollën"Martin Camaj"-Gurraçkoc— vlëra – 28 880.00€.

#### **A R S I M I – Planifikimi dhe shpenzimi i Buxhetit (I-VI/ 2019) :**

Planifikimi dhe shpenzimi i Buxhetit në Drejtorin Komunal të Arsimit, për periudhën Janar-Dhjetor 2021, i deklaruar në formën numerike dhe në përqindje të shpenzimit sa vijon:

| <u>Planifikimi - 2020</u>                                                                                        | <u>Shpenzimi /2020</u> | <u>Shpenz.në %</u> |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|--------------------|
| * Buxheti për paga .....3 935 000 €                                                                              | ---- 3 847 685.67 €    | - - - 97.78%       |
| * Mallra e shërbime.....236,001.00 €                                                                             | --- 223,728.53 €       | - - - 94.79%       |
| * Komunal.....46,954.00 €                                                                                        | --- 40,748.53 €        | - - - 86.78 %      |
| * Subvencione dhe transfere.....53,750.00 €                                                                      | --- 52,340.00 €        | --- 97.36%         |
| * Të hyrat vetanake.....59,220.00 €                                                                              | --- 44,898.86 €        | --- - 75.81%       |
| *Total Buxheti i shpenzuar për vitin 2021 sipas kategorive ekonomike,por pa shpenzime kapitale është.....75.81 % |                        |                    |

**Drejtori i DKA-së:  
Naim Behluli**

## DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE HIDROEKONOMI

### Sektori i Bujqësisë

Aktivitetet ne periudhën janar- dhjetor

Komuna e Istogut përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është e orientuar ne mbështetje te faktorëve te prodhimit, ne stimulimin e fermerëve dhe ne krijimin e një ambienti sa me te favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi qe te arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë me efikas i resurseve natyrore te cilat i posedon komuna jonë. Bujqësia dhe pylltaria janë sektorët kryesorë te cilët mund te kontribuojnë dukshëm ne zhvillimin e përgjithshëm ekonomik te vendit. Duke u bazuar në plan programin e punës në kuadër të Drejtorisë brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me grupet e interesit-fermerët, shoqatat e ndryshme, institucione të ndryshme etj. Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në sektorin e bujqësisë që kanë qenë planifikuara në programin e punës.

#### 1. Aktivitetet në periudhën janar- dhjetor 2021

Ne kuadër te DBPZHR-së nga muajin janar janë realizuar një mori aktivitete. Nder me kryesorët do te paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor te punës, pranimi i aplikacioneve për subvencione te qumështit për gjashtëmujorin e dytë te vitit 2020 për fermerët blegtor (MBPZHR hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPH, -së pranon aplikacionet dhe te njëjtat i dorëzon ne Ministri për pagesë, kjo thirrje ka qen e hapur nga 15 janari-15 shkurt ), 97 aplikacione
- DBPH ka ndërmarrë masa dhe është pregaditur me kohë për hapjen e thirrjeve nga MBPZHR për pagesa direkte, me material shpenzues, pajisje teknologjike
- Po ashtu jemi pregaditur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje te stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 4 zyrtar te rijnë me kontrata ne vepër te cilët edhe me herët kanë qen te trajnuar dhe te pregaditur për procedurat e aplikimit dhe digjitalizimit te parcelave.
- Gjatë muajit janar dhe shkurtë , kemi pasur një situat te vërshimeve, ku me ketë rast kemi pasur 34 kërkesa te fermerëve për vlerësim te demit, te njëjtat ne ketë periudhë nuk janë përfunduar nga stafi ,shkaku i zhvillimeve qe kanë ndodhur me pastaj ne ketë drejtori (paraburgosja e stafit )
- Si vazhdimësi e projektit për përkrahje të fermerëve me koshere te bletëve, ne muajin korrik janë shpërndara ,400 koshere me bletë, po ashtu ne muajin dhjetor te gjithë fermat qe mbarështojnë dhi qumështore me numër nga 5-60 krerë janë subvencionuar nga komuna me nga 15 €/ krerë ne vlerën prej ; 9,315.00 €
- Janë kompensuar demet e fermerëve te ndodhura ne kafshët shtëpiake nga kafshët e egra te vitit 2020 , ku përfitues kanë qenë 23 fermer ,vlera totale e përkrahjes ka qenë 18.078 €

- Ne bashkëpunim me organizatën IADK me te cilën kemi te nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ne kuadër te projektit , Është përmbyllur projekti me organizatën IADK, “Krijimi i vendeve te reja te punës” ku përfitues kanë qenë 11 fermer nga komuna e Istogut, ne mbjellje te bimëve aromatike.
- Janë iniciuar procedurat e prokurimit për projektet kapitale
- Pranimi dhe përgjigjeje ne kërkesa te palëve
- Shërbime te tjera ne kuadër te drejtorisë si; vërtetime për fermer, vlerësimi i dëmeve te ndryshme , etj

## 2. Lëndët e pranuar dhe zgjidhja e tyre

Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar 415 kërkesa te ndryshme te palëve

| Pranuar | Ne proces | Miratuara | Refuzuara | Pezulluar |
|---------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| 415     | 2         | 165       | 181       | 61        |

Gjatë fazës se aplikimit te fermerëve për pagesa direktet janë pranuar dhe procedura 1106 aplikacione dhe 97 aplikacione për pagesa te qumështit te specifikuar si me poshtë dhe 415 kërkesa te tjera.

Totali i lëndëve te trajtuara ; 1521 copë +97 copë = 1618 lëndë

| Nr. | Sektori       |                  | Viti 2021 | Sipërfaqja/sasia   | Nr. I aplikacioneve |
|-----|---------------|------------------|-----------|--------------------|---------------------|
| 1   | Lavërtari     | Grurë sipërfaqe  |           | 1.181.78           | 197                 |
|     |               | Grurë kg         |           | 3.185.117          | 78                  |
|     |               | Grurë për farë   |           | 112.93             | 05                  |
|     |               | Thekër           |           | 71.15              | 15                  |
|     |               | Elb              |           | 29.6               | 13                  |
|     |               | Tërshëra         |           | 23.72              | 11                  |
|     |               | Misër            |           | 851.88             | 297                 |
| 2   | Perimekultura | Perime ne fushë  |           | 82.34              | 65                  |
|     |               | Perime ne sera   |           | 1.27               | 04                  |
|     |               | Kunguj           |           | 5.58               | 05                  |
| 3   | Pemëtari      | Pemë             |           | 288.02             | 156                 |
|     |               | Material fidanor |           | 39.600 copë fidanë | 01                  |
| 4   | Blegtori      | Lopë qumështore  |           | 5.853              | 459                 |
|     |               | Qumësht litra    |           | 3.610.385          | 84                  |

|   |                              |                  |  |            |     |
|---|------------------------------|------------------|--|------------|-----|
|   |                              | Bletë            |  | 6.734      | 116 |
|   |                              | Dele             |  | 7.653      | 74  |
|   |                              | Dhi              |  | 997        | 16  |
|   |                              | Viça për majmëri |  | 432        | 27  |
|   |                              | Dosa             |  | 27         | 03  |
| 5 | Shpezëtari                   | Pula             |  | 28.400     | 02  |
|   |                              | Akuakulturë      |  | 227.656 kg | 03  |
| 6 | Bimë mjekësorë dhe aromatike | Konvencionale    |  | 24.24      | 16  |
|   |                              |                  |  |            |     |
| 7 | Bujqësi organike             | Organike         |  | 165.08     | 07  |

### 3. Projektet kapitale

Ne këtë vit janë implementuar 10 projekte që kanë të bëjnë me përmasimin e infrastrukturës së ujitjes dhe hapja e një rruge malor për tu mundësuar qasje me të lehtë blegtorëve në kullosa. Janë në implementim edhe dy projekte të tjera që janë dy vjeçare për betonim të kanaleve të ujitjes;

Janë përfunduar projektet;

1. Rregullimi i përroit vërshues në Kaliqan
2. Betonimi i kanalit Dobrushë –Lubovë
3. Betonimi i kanalit në Dubovë
4. Betonimi i kanalit Llukafci i Begut
5. Betonimi i kanalit Bujup-Demiraj
6. Betonimi i kanalit në lagjen Gjocaj Tomoc
7. Hapja e rrugës malore Radushë- Bajshe
8. Betonimi i kanalit Termal-Onix

Në vazhdim janë projektet ;

1. Betonimi i kanalit në lagjen Balaj- Lluga
2. Betonimi i kanalit të Lubeniqeve

### 4. Sektori i pylltarisë

1. Aktivitete për periudhën janar- dhjetor / 2021

- Është vazhduar me aktivitet të rregullta sipas planifikimeve vjetore, angazhim në mbrojtje dhe ruajtje të pyjeve, florës dhe faunës
- Pjesëmarrje aktive në shuarjen e zjarreve gjatë verës me shërbimin e zjarrfikësve në lokacionet Mokna-Ahishta e smetit
- Me vendim të drejtorisë së BPH në muajin maj janë bërë regjistrimet e përgjithshme të demit pyjor
- Është bërë shijimi i masës drunore së bashku me zyrën rajonale të APK-së , për shitje të rregullt dhe për furnizim me qytetar

- Është bërë lëshimi i lejeve për prerje në pyje private, damkimi dhe dhëna e fletë përcjelljeve

Përmbledhje tabelore e aktiviteteve për përdhën raportuese

| Shitje e masës drunore në bazë të kontratave |               |         | Shitje e lirë për qytetar | Fletëparaqitjet |              | Konfiskimet |            | Shitjet totale € |
|----------------------------------------------|---------------|---------|---------------------------|-----------------|--------------|-------------|------------|------------------|
| Dru zjarri m³                                | Ahu teknik m³ | Breu m³ |                           | Penale          | Kundërvajtje | Dru teknik  | Dru zjarri |                  |
| 1485.64                                      | 13.97         |         | 1058.60                   | 24              | 36           | 84.14       | 48.10      | 47,197.09        |
|                                              |               |         |                           |                 |              |             |            |                  |

## 5. Sfidat

Drejtoria e bujqësisë këtë vit raportues është përballur me sfida të shumta në përmbushjen e detyrave dhe funksionimit si më poshtë

- Mungesë e stafit (si pasojë e arrestimeve dhe mbajtjes në paraburgim të një pjese të stafit. Drejtoria po përballë me mungesë të stafit profesional në disa sektorë dhe po i pamundësohet kryerja e punëve normale dhe atyre të parapara me ligj.
- Sipërfaqet e tokave bujqësore komunale të cilat nuk janë dhënë në shfrytëzim përmes ankandit
- Mos themelimi i vendgjatësisë sipas obligimeve ligjore detyrë e len pas që shumë vite edhe për kundër kërkesave të vazhdueshme dhe vendimeve të inspektoratit qendror
- Numri i madhë i kërkesave të fermerëve për ndihmë financiare për dëmtim të kafshëve shtëpiake nga kafshët e egra dhe ngordhjet natyrore, objekte bujqësore etj

## 6. Rekomandime

- Rekrutim i menjëhershëm i stafit për shërbime të veçanta për pranim të aplikacioneve të pagesave direkte (subvencione), si dhe trajnimi i tyre.
- Rekrutim i stafit të rregullt profesional, sipas ligjit për zyrtarët publikë në tri pozita të domosdoshme, zyrtar për bujqësi, zyrtar financiar dhe zyrtar për blegtori
- Vazhdimi i procedurave për dhënie në shfrytëzim të tokave bujqësore për periudhë afat shkurtër (1-15 vite), sipas shkresës së drejtuar nr 09-183-2021 të datës 20.12.2021
- Bartja në menaxhim të zonës së parkut nacional “ Bjeshkët e Nemuna “, që shtrihet në territorin e komunës së Istogut, në Agjencinë për mbrojtje të Mjedisit, e cila vazhdon të menaxhohet gabimisht nga Komuna e Istogut

- Themelimi i vend gjuetisë, një punë e filluar ne vitin 2014 e cila ka mbetur e pa përfunduar edhe sot e kësaj dite.
- Vazhdimi i procedurave për vazhdimin e projektit “ Trasimi i kanalit te ujitjes dhe rrugës rurale ne fshatin Muzhevinë, projekt i ndërprer për shkak te gabimeve ne paramases jo te saktë ne projekt

## 7. Përfundim

Me gjithë sfidat e lartë cekura, ne kuadër te stafit te drejtorisë ka pasur angazhime ne përmbushje te detyrave dhe implementim te projekteve. Po ashtu gjatë kësaj periudhe raportuese kemi mbajtur kontakte te rregullta me institucionet e nivelit qendror, shoqata te ndryshme dhe komunikime te tjera , me qellim te ndikimit qe përmes këtyre aktiviteteve te përmissohen dhe ndihmohen fermerët ne zhvillimin e mëtejme te bujqësisë.

Implementimi i rekomandimeve te lartcekura do ti mundësoi sektorit te bujqësi ,një funksionalizim dhe përmbushje te detyrave dhe te kompetencave ,sipas ligjeve ne fuqi. Mungesa e stafit te rregullt po pamundëson edhe themelimin e disa komisioneve profesionale shumëvjeçare qe na obligojnë aktet ligjore ne fuqi.



## DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

### TATIMI NË PRONË

Sektori i Tatimit në Pronë funksionon në kuadër të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, pranë Komunës së Istogut. Në kuadër të punëve dhe detyrave të punës gjatë periudhës prej 01.01.2021 deri me 31.12.2021, janë kryer këto pune dhe detyra të punës: **Lëshuarja e faturave tatimore për vitin 2021** – për këtë vit kalendarik janë lëshuar gjithsejtë **13.750** fatura, ato janë:

- **për objekte të paluajtshme**, për këto kategori: objekte banimi, afarizmi, industriale dhe bujqësore;
- **për parcela**, për këto kategori: parcela për shtëpi familjare, afariste, industriale dhe pyjore. Është viti i tretë që është aplikuar tatimi në pronë për të gjitha parcelat e cekura me lartë, përveç parcelave bujqësore.

**Shuma e faturuar** - për këtë vit tatimor shuma e faturuar gjithsejtë është **482.686,87 €**, prej tyre **335.869,64 €** janë për objekte, kurse **146.817,23 €** janë për parcela.

**Planifikimi i inkasimit**- Sipas të Hyrave Vetanake Komunale për vitin 2021 është parapare të inkasohen nga tatimi në pronë, shuma prej **435.663 €**, prej tyre **343.176 €** prej objekteve dhe **92.487 €** prej parcelave.

**Shpërndarja e faturave**-Faturat tatimore për të gjithë tatimpaguesit e tatimit në pronë, janë shpërndare përmes Postës së Kosovës- Njësia në Istog. Nga numri i përgjithshëm i faturave, shpërndarja bëhet vetëm për faturat që kanë ngarkesë tatimore mbi 3 €, sipas Ligjit në fuqi. Sipas Raportit mbi pranim-dorëzimin e dërgesave të faturave të tatimit në pronë për këtë vit, i datës 30.03.2021 nga PK -Njësia në Istog, gjendja e shpërndarjes së faturave është si më poshtë:

| Nr.faturave | Shpërndarja | Mbetja | Përqindja |
|-------------|-------------|--------|-----------|
| 9.423       | 9.304       | 119    | 98,74 %   |

Mbetja prej 119 faturave të pashpërndara, është si rrjedhojë e ndërrimit të vendbanimit nga tatimpaguesit si dhe adresat jo të sakta, sipas arsyetimit të PK.

**Ndërhyrjet në sistemin e tatimit në pronë**- sipas shënimeve të grumbulluara nga terreni dhe në zyre, për këtë vit janë kryer këto ndërhyrje në sistemin e tatimit në pronë :

- **599** objekte të reja të regjistruara,
- **3.551** modifikimi i të dhënave të pronës,
- **3.481** modifikimi i të dhënave të tatimpaguesit.

**Ankesat** - gjatë afatit të parashtrimit të ankesave, për këtë vit janë pranuar gjithsejtë **44** **Ankesa dhe Kërkesa** nga tatimpaguesit. Prej tyre 14 Ankesa janë parashtruar ndaj faturës së tatimit në pronë për objekte, ndërsa 30 Kërkesa për korrigjim të parcelave. Komisioni për verifikim, ka kryer verifikimin për të gjitha rastet. Për secilin rast janë punuar Vendimet me shkrim dhe është ndërhyrë në sistemin për korrigjimin e ngarkesave tatimore për rastet e Aprovuara.

**Vërtetimet** - Gjatë punës me palë, gjatë kësaj periudhe raportuese janë lëshuar rreth **12.250 Vërtetime** nga sistemi i tatimit në pronë, me kërkesë të palëve, të cilat shërbejnë për nevoja personale (transfer prone, aplikim për tender , aplikim për subvencione nga bujqësia, aplikim për ndihme sociale etj.) , si dhe për regjistrim të automjeteve. Kushtëzimi i regjistrimit të automjeteve me pagesën e tatimit në prone është pezulluar me Vendim Nr. 06 /42 , Datë: 27.10.2021 nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

**Inkasimi**-gjatë këtij viti inkasimi i tatimit në pronë sipas muajve, dhe krahasimi me vitin e kaluar, është si më poshtë:

| <b>MUAJI</b>      | <b>Viti 2020 në €</b> | <b>Viti 2021 në €</b>       |
|-------------------|-----------------------|-----------------------------|
| Janar             | 22.537,76             | 26.283,51                   |
| Shkurt            | 16.234,98             | 58.392,98                   |
| Mars              | 10.837,80             | 46.982,49                   |
| Prill             | 11.595,30             | 47.614,44                   |
| Maj               | 18.972,09             | 37.216,87                   |
| Qershor           | 24.063,38             | 40.034,82                   |
| Korrik            | 42.287,88             | 39.511,00                   |
| Gusht             | 44.905,38             | 72.260,49                   |
| Shtator           | 20.181,26             | 44.372,50                   |
| Tetor             | 24.846,92             | 24.102,59                   |
| Nentor            | 22.289,37             | 13.232,05                   |
| Dhjetor           | 40.715,80             | 24.057,78                   |
| <b>Gjithsejtë</b> | <b>299.467,92</b>     | <b>474.061,52 ose 109 %</b> |

Sipas Planifikimit për të Hyrat Vetanake Komunale, në emër të tatimit në pronë për **vitin 2021** janë planifikuar të inkasohen **435.663,00 €** .

Të inkasuara deri në ditën e raportimit, me **31.12.2021** janë **474.061,52 € ose 109 %** në raport me planifikimin.

# DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM

## 1. Hyrje

Ky raport pasqyron aktivitetet, angazhimet dhe punët e kryera nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ( ne tekstin e më tutjeshëm - DEZH), gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2021. Objektivi kryesor i DEZH për vitin 2021, është ngritja e ndikimit të tij në realizimin e projekteve të filluara dhe planifikimin e investimeve në projektet e reja, si dhe kryerja e punëve tjera varësisht nga detyrat dhe obligimet e stafit të kësaj Drejtorie. Gjatë periudhës së raportimit stafi i kësaj Drejtorie është në proces të kryerjes së punëve të filluara ne vitin 2020 në mënyrë që të ndikoj që ky sektor të jetë sa më eficient. Në vijim, do të jepet raporti vjetor i punës për çdo sektor dhe zyre, që vepron në kuadër të DEZH.

**Qëllimi :** Njoftimi i anëtarëve të Komitetit për Politikë e Financa, Anëtarët e Kuvendit Komunal dhe të gjithë drejtorët e drejtorive me realizimin e investimeve të planifikuara, zhvillimin, shpenzimet dhe rezultatit të arritur në raport me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit. Përmes këtyre raporteve sigurohen informacione të rëndësishme relevante për opinionin publik në lidhje me performancën fiskale, rezultatet e programeve, rrjedhën e parasë së gatshme etj.

**Sektori për ekonomi:** Gjatë kësaj periudhe personeli i sektorit të ekonomisë është angazhuar në kryerjen e këtyre punëve dhe detyrave si: \_Organizimi dhe koordinimi i punëve të sektorit për ekonomi , me qëllim të rritjes së efikasitetit në punë. \_Përgatitja e listës së borxheve për ngarkesa vjetore për përdorimin dhe shërbimin e pijeve alkoolike për ndërmarrje hoteliere, të parapara me Rregulloren Komunale 2/2021 si dhe regjistrimi këtyre pagesave. Përgatitja dhe lëshimi i faturave përmes intranetit për ngarkesa vjetore për përdorimin dhe shërbimin e pijeve alkoolike për ndërmarrjet hoteliere në bazë të Rregullores Komunale 2/2021. Angazhimi, në sistemin e ARBK për regjistrimin e bizneseve, ndryshime dhe shuarje të bizneseve. Përgjigje ndaj kërkesave të palëve dhe procedimi i tyre përmes intranetit. Lëshimi i vërtetimeve bizneseve lidhur me përmbushjen e obligimeve për ngarkesa të afarizmit vjetor. Lëshimi i referencave për biznese në bazë të kontratës për realizimin e projekteve kapitale. \_Përcjellja e aktivitetit ekonomik të bizneseve, mbledhja e shënimeve për aktivitetin e tyre ,ndihma e dhëne dhe informimi rreth regjistrimit,shuarjes dhe ndryshimeve në biznes. Gjithashtu janë punuar edhe shkresa të ndryshme zyrtare ,si dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme të palëve drejtuar Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, gjegjësisht Sektorit për Ekonomi.

Në Qendrën Komunale të Bizneseve janë kryer këto punë:

|                                                |     |
|------------------------------------------------|-----|
| - Regjistrim i bizneseve-----                  | 136 |
| - Shuarje të bizneseve -----                   | 13  |
| - Ndryshime në biznes -----                    | 62  |
| - Informata të biznesit -----                  | 52  |
| - Vërtetim biznesi -----                       | 6   |
| - Certifikata të reja (NUI) -----              | 61  |
| - Këshillime për regjistrim të bizneseve ----- | 126 |
| - Këshillime për ndryshime në biznes -----     | 134 |
| - Këshillime për shuarje të biznesit -----     | 32  |
| - Certifikata duplikat -----                   | 08  |

Duhet te theksohet se me vendim të MTI-së, regjistrimi i bizneseve bëhet pa pagesë (taksa) ndërsa taksat tjera ende aplikohen (për ndryshime në biznes, shtim i aktiviteteve, ndërrimin e llogos etj.) Përcjellja e aktivitetit ekonomik të bizneseve, vizita e këtyre bizneseve, mbledhja e shënimeve për aktivitetin e tyre, ndihma e dhënë dhe informimi rreth regjistrimit dhe ndryshimeve në bizneset e tyre . Mbledhja, përpunimi i shënimeve dhe dërgimi i tyre në Ministrinë përkatëse, plotësimi i formularëve dhe pyetësorëve me shënimet e kërkuara. Gjithashtu janë punuar edhe shkresa të ndryshme zyrtare si dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme të palëve drejtuar Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim, gjegjësisht Sektorit për Ekonomi.

**Sektori i zhvillimit:** *Tabela e projekteve kapitale të cilat janë në procedurë e sipër për periudhën Janar - Dhjetor 2021*

| Nr. Ren. | Emërtimi i projektit                    | shuma e planifikuar | burimet e financimit | vërejtje   |
|----------|-----------------------------------------|---------------------|----------------------|------------|
| 1        | Hartimi i projekteve për infrastrukturë | 70,000.00           | GQ dhe THV           | përfunduar |
| 2        | Mbikëqyrja e projekteve kapitale        | 15,000.00           | GQ                   | përfunduar |
| 3        | Ndërtimi i rrugëve në Gurrakoc          | 40,000.00           | GQ                   | përfunduar |

|                    |                                                                                                            |                   |            |                   |
|--------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------|------------|-------------------|
| 4                  | Ndërtim i rrugëve në Vrellë                                                                                | 35,000.00         | GQ dhe THV | përfunduar        |
| 5                  | Ndërtimi i rrugëve në Istog                                                                                | 80,000.00         | GQ         | përfunduar        |
| 6                  | Ndërtimi i rrugëve në Banjë                                                                                | 40,000.00         | GQ         | përfunduar        |
| 7                  | Ndërtimi i rrugës Selim Brahimaj, Shushicë                                                                 | 30,000.00         | GQ         | përfunduar        |
| 8                  | Ndërtimi i rrugëve Mbreti GENT dhe Camëria në Dushkajë                                                     | 20,000.00         | GQ dhe THV | përfunduar        |
| 9                  | Vazhdimi i ndërtimit të rrugës Ramë Ademaj, lagjja Ademaj-II                                               | 35,000.00         | GQ dhe THV | përfunduar        |
| 10                 | Ndërtimi i rrugës Habib Osmani, Cërrcë                                                                     | 20,000.00         | GQ         | përfunduar        |
| 11                 | Ndërtimi i rrugës Vllëzerit Hasanaj, Cërrcë                                                                | 20,000.00         | GQ         | përfunduar        |
| 12                 | Ndërtimi i rrugës Krojet, Tomoc                                                                            | 35,000,00         | GQ dhe THV | përfunduar        |
| 13                 | Ndërtimi i rrugëve Fushëkuqe dhe Molla e kuqe, Kovragë                                                     | 50,000,00         | GQ dhe THV | projekt dy vjeçar |
| 14                 | Asfaltimi i rrugës në lagjen Elshani, Staradran                                                            | 20,000.00         | GQ         | përfunduar        |
| 15                 | Ndërtimi i rrugëve në fshatin Drejë                                                                        | 22,000.00         | GQ         | përfunduar        |
| 16                 | Ndërtimi i rrugës në lagjen Imeraj, Padalishtë                                                             | 20,000,00         | GQ         | përfunduar        |
| 17                 | Ndërtimi i rrugës Shaban Sadikaj dhe Brigada 133, Adrian Krasniqi, Lagjja Maksutaj dhe Gashi, në Studenicë | 27,000,00         | GQ         | përfunduar        |
| 18                 | Asfaltimi i rrugës Rexhë Kastrati, Kashicë                                                                 | 20,000.00         | GQ         | në proces         |
| <b>GJITHËSEJTË</b> |                                                                                                            | <b>599,000,00</b> |            |                   |

# DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Kadastrës dhe Gjeodezisë është e organizuar në këta sektorë:

- 1. Sektori për Gjeodezi;**
- 2. Sektori dhe Kadastër**

Gjatë kësaj kohe të raportimit, në këta sektorë, zyrtarët janë ngarkuar në kryerjen e punëve sipas përshkrimit të vendeve të punës, ku detyrat kryesore janë:

- Është përgjegjëse për zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale,, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën
- Ofron shërbime profesionale dhe shërbime të tjera për subjekte të interesuara;
- Digjitalizon pikat poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale);
- Azhurnon pjesën grafike, në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe i transformon me parametrat e dhëna për transformim;
- Ofron shërbime për ndarjen e ngastrave dhe shënimin e kufijve në rastet e shpronësimeve;
- Kryen punë profesionale, në fushën e gjeodezisë (ndryshimet e bëra gjatë matjeve-bartjes së tyre në programin e gjeodezisë);
- Ofron shërbime për shënimet e digjitalizuara (dhënien e koordinatave në terren). Kontrollon rrjetet dhe matjet gjeodezike;
- Incizon sipërfaqet e ndërtesave dhe pjesëve të tyre;
- Regjistron pronën e paluajtshme dhe tokën komunale;
- Korrigjon regjistrin (RDPP) sipas procedurave dhe dispozitave ligjore në fuqi; Azhurnon e regjistrin e pronën, në bazë të dokumenteve të verifikuara dhe shënimeve të tjera nga dokumentacioni arkivor si dhe regjistrin të ndërrimeve të mjeteve nga terreni;
- Zbaton procedurat rreth transaksioneve të pronës publike në RDPP;
- Udhëheq me kadastrën etazhore të banesave, ndërtesave, si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë të ndërtuara banesat;
- Regjistron dhe çregjistron hipotekat;
- Lëshon certifikata për patundshmëri, sipas kërkesave;
- Nxjerr vendime për miratim ose refuzim të kërkesave;
- Kryen edhe punë të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë.

Më poshtë kemi paraqitur të dhënat statistikore rreth kërkesave të parashtruara dhe lëndëve si në vijim:

Trashëgimi **104** raste; Parcelim **302** raste; \_Bartje pronësie **768** raste; Korrigjime **20** raste; Historiate **42** raste; Hipoteka **54** raste; Fshirje e hipotekës **78** raste; certifikatave pronësore **3779**; \_Kopje plani **1764**; Kërkesa për dalje zyrtare të gjeodetëve në terren **30**; Këmbim i pronës së paluajtshme të komunës me pronën private me qëllim të realizimit të interesit të përgjithshëm **9** raste; kërkesa për produkte kadastrale **325** raste; pagesa për shërbime të ndryshme **205** raste; Certifikatë që nuk ka pronë **57** raste, Kërkesa, aktvendime, përgjigje në shkresa, uzurpime ( zyrtari ligjor ) **12** raste.

Të dhëna e lartshënuara të paraqitura në mënyrë tabelare

| 1.  | Trashëgimi                                                          | <b>104</b>  |
|-----|---------------------------------------------------------------------|-------------|
| 2.  | Parcelim                                                            | <b>302</b>  |
| 3.  | Transferim-kontrata-bartje pronësie                                 | <b>768</b>  |
| 4.  | Korrigjime                                                          | <b>20</b>   |
| 5.  | Historiate                                                          | <b>42</b>   |
| 6.  | Hipoteka                                                            | <b>54</b>   |
| 7.  | Fshirje e hipotekës                                                 | <b>78</b>   |
| 8.  | Certifikata pronësore                                               | <b>3779</b> |
| 9.  | Kopje Plani                                                         | <b>1764</b> |
| 10. | Dalje e gjeodetëve në terren sipas kërkesave zyrtare                | <b>30</b>   |
| 11. | Këmbim i pronës së paluajtshme                                      | <b>9</b>    |
| 12. | Kërkesa për produkte kadastrale                                     | <b>325</b>  |
| 13. | Pagesa të ndryshme                                                  | <b>205</b>  |
| 14. | Certifikata që nuk posedon pronë                                    | <b>57</b>   |
| 15. | Kërkesa, aktvendime, përgjigje në shkresa, uzurpime- zyrtari ligjor | <b>12</b>   |
| 1.  | <b>Totali</b>                                                       | <b>7549</b> |

Të hyrat e realizuara 85,236.00 Euro.

Drejtori,  
**Agon Dreshaj**

## DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS

Në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mjedis, gjatë vitit 2021, kujdes i veçantë i është kushtuar përfundimit të lëndëve të vjetra për leje ndërtimi dhe monitorimi i respektimit të afateve ligjore. Kanë vazhduar takimet e shpeshta brenda drejtorisë, duke tentuar që të eliminohen pengesat në shqyrtim të lëndëve. Vonesat në shqyrtim janë evidentuar në lëndët që janë në trajtim ende pa arritur zgjidhjet urbane, andaj është aprovuar zgjidhje urbane që do t'u ndihmojë kërkuuesve që të konsultohen për zgjidhje urbane paraprakisht kërkesës për kushte ndërtimore. Është punuar në atë që zgjidhjet urbane të sigurojnë qëndrueshmëri të zhvillimit, si proces para kushteve të ndërtimit për ndërtesat e kategorisë II. Gjatë këtij viti janë përfunduar lëndët e vjetra me dokumente konkrete-kushte ndërtimi dhe leje ndërtimi. Për më tepër, vonesa paraqesin procedurat për legjitimimin e marrëveshjeve të ndryshme pronësore si bashkimi i parcelave ose shpronësimi, si dhe ndërrimi i destinimit të tokës, duke mos lënë anash edhe vonesat e palëve për të marrë informimet për plotësim dokumentacioni.

Sfidë për DPUM është edhe implementimi i projekteve që i përkasin Drejtorisë sonë. Janë në implementim 6 projekte kapitale me një buxhet prje mbi 250,00.00 € të listuara më poshtë:

- PWRFUNDIMI I PARKUT TE QYTETIT (ISH RADUSHA) - VLERA E KONTRATES ..... € (DORWZIMI I PROJEKTIT 2021)
- RREGULLIMI I TROTUAREVE NË ISTOG (ZONA URBANE) VLERA E KONTRATES ..... €
- MIRËMBAJTJA E ADRESAVE VLERA E KONTRATES ..... €

### Sektori i urbanizmit

Gjatë vitit 2021, është evidentuar numër i caktuar i kërkesave për shkak të Pandemisë dhe intensiteti i punës në sektor ka treguar një kujdes në zgjidhje të lëndëve. Janë evidentuar mbi 350 kërkesa, prej të cilave 119 kërkesa për leje ndërtimi. Janë trajtuar 113 kërkesa, nga 350 sa janë pranuar, janë lëshuar 109 leje ndërtimi, nga të cilat 4 ndërtesa të banimit shumëkatëshe dhe 88 ndërtesa individuale, 11 ndërtesa për zhvillim ekonomik(grante) dhe 3 ndërtesa tregtare-afariste. Sikur edhe është paraqitur në tabelë, gjatë këtij viti janë përcaktuar kushte-pëlqime ndërtimi për 64 kërkesa, derisa 45 kërkesa janë përfunduar me pëlqime të ndryshme për grante të ndryshme, pëlqime parimore paraprake sa i përket pronës dhe të ngjashme. Janë edhe 102 kërkesa të cilat kanë marr përgjigje si të ceduara, të refuzuar dhe të pa kompletuara.

| Koha   | Leje ndërtimi | Kushte ndërtimi | Certifikatë përdorimi | Pelqime për ndërtim | Akte zyrtare | Njoftime | Përgjigje (refuzuara) |
|--------|---------------|-----------------|-----------------------|---------------------|--------------|----------|-----------------------|
| Janar  | 3             | 0               |                       |                     |              |          |                       |
| Shkurt | 8             | 2               |                       |                     |              |          |                       |



|          |    |    |                                 |    |    |    |    |
|----------|----|----|---------------------------------|----|----|----|----|
| Mars     | 4  | 2  | 1<br>.....<br>..<br>1<br>1<br>4 | 39 | 27 | 61 | 34 |
| Prill    | 13 | 3  |                                 |    |    |    |    |
| Maj      | 14 | 0  |                                 |    |    |    |    |
| Qershor  | 5  | 2  |                                 |    |    |    |    |
| Korrik   | 6  | 0  |                                 |    |    |    |    |
| Gusht    | 0  | 0  |                                 |    |    |    |    |
| Shtator  | 0  | 1  |                                 |    |    |    |    |
| Tetor    | 1  | 0  |                                 |    |    |    |    |
| Nëntor   | 11 | 4  |                                 |    |    |    |    |
| Dhjetor  | 19 | 6  |                                 |    |    |    |    |
| Gjithsej | 84 | 20 | 7                               | 39 | 27 | 61 | 34 |

Drejtoria realizon të hyra nga taksat për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës dhe nga taksa administrative për leje të ndërtimit, bazuar në “Rregullore mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01/20 dt. 24.04.2020.

Në këtë periudhë raportuese janë realizuar të hyrat buxhetore në vlerë prej **112.200,0 €**, nga taksa administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, si dhe nga taksa administrative për leje të rrënimit. Gjithashtu janë realizuar **6.420,0 €** nga taksa për pajisjen më certifikatë pëlqime dhe shërbime tjera në kuadër të DPUM. Gjithsej, drejtoria ka realizuar **118.620,0 €** euro. Është vazhduar puna në plotësimin e informatave në sistemin e monitorimit të procedurës për marrjen e lejes së ndërtimit (Permit tracking System), ku paraqiten informatat për qytetarë, si dhe është punuar në informimin e zyrtarëve për lëndët të cilave u ofrohet afati ligjor i shqyrtimit. Në këtë periudhë është ripunuar dokumenti me udhëzues dhe informatorë për qytetarë për procedurën e aplikimit për leje të ndërtimit, duke përfshirë sugjerimet e ekspertit nga projekti i USAID-it, të cilat informata janë përgatitur në formë postierësh dhe do të publikohen në vende të dukshme për informimin sa më të mirë të qytetarëve me procedurat dhe dokumentet e nevojshme për pajisje me leje ndërtimi. Përveç trajtimit të lëndëve, zyrtarët e sektorit kanë qenë të angazhuar edhe me aktivitete të tjera përcjellëse, si mbikëqyrje të projekteve që investohen nga Komuna, si dhe mbikëqyrje të planeve rregulluese në revidim. Një ndër punët më me rëndësi është dhe emërtimi i rrugëve, i udhëhequr nga Sektori i shërbimeve të përbashkëta, punë kjo e përfunduar me rezultat pozitiv. Duhet theksuar se këtë vit është krijuar dhe Zyra për marrëdhënie me publikun, në mënyrë të organizimit të ngjarjeve të ndryshme brenda drejtorisë, takimet me institucione dhe palë të ndryshme, si dhe prononcime mediatike të cilat kanë të bëjnë me DUNMM-në.

#### Aktivitetet e planifikuara:

- ☐ Zbatimi i Bazës ligjore për planifikim e ndërtim-shqyrtimit të lëndëve me një dinamikë të pranueshme, duke respektuar afatet ligjore;
- Hartimi i dokumenteve me rregullativa që lehtësojnë funksionimin e Sektorit;
- Vlerësimi i lëndëve nga Planerët urban, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje;
- ☐ Përgatitjet që të integrohen të dhënat e lejeve të ndërtimit në Sistemin vrojtues;
- ☐ Përpunimi i web-faqes së Komunës sa i përket Drejtorisë;
- ☐ Përmirësimi i shërbimit të informimit të qytetarëve;
- ☐ Hartimi i zgjidhjeve urbane dhe prezantimi në drejtori dhe në publik;
- ☐ Avancimi i sistemit të vrojtimit të lejeve
- ☐ Informimi i qytetarëve për çfarëdo informate që u intereson sa i përket Urbanizmit;
- ☐ Takimet me palë për identifikimin e problemeve, adresimin dhe shqyrtimin e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi;
- ☐ Identifikimi i pengesave në zbatim të planeve;
- ☐ Takimet me qytetarët për diskutimet për Hartën Zonale
- ☐ Kryerja e lëndëve në bazë të kërkesave të palëve në afat;
- ☐ Përgatitja e detyrave projektuese;
- ☐ Mbikëqyrja e kontratave të të gjitha llojeve;
- ☐ Finalizimi i rregulloreve të filluara;
- ☐ Këshillimi i drejtorit dhe sektorëve tjerë për çështjet e ndërtimit;
- ☐ Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve – certifikatë përdorimi, të ndërtuara me leje;
- ☐ Pranimi i lëndëve dedikuar vetëm për Sektorin e legalizimit;
- ☐ Fillimi i trajtimit të lëndëve të legalizimit;
- ☐ Hartimi i databazës elektronike të brendshme për kërkesat për legalizim, ankesa, kërkesa të ndryshme dhe arkivimit (kontroll i brendshëm i procesit të lëndëve, sistem qendror);
- ☐ Fushata informuese dhe sensibilizuese;
- ☐ Pranimi i aplikacioneve të reja për legalizim;
- ☐ Legalizimi i objekteve të para;
- ☐ Hartimi i përmbajtjes minimale (sqarimi) të dokumentacionit për aplikim për legalizim;
- ☐ Hartimi i draftit të parë për Planin lokal të veprimit në mjedis;
- ☐ Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese dhe mbjellja e drurëve, duke përfshirë disa parqe të planifikuara më parë;
- ☐ Fushata vetëdijesuese nëpër institucionet shkollore në lidhje me shumë aspekte mjedisore për qëllim vetëdijesimi;
- ☐ Shtimi i sipërfaqeve gjelbëruese në pjesët e ndryshme të qytetit;
- ☐ Mbjellja e drurëve dekorativë;
- ☐ Shënimi i aktiviteteve mjedisore, si: 22 Prilli - Dita botërore e Tokës, 5 Qershori - Dita Botërore e Mjedisit, si dhe aktivitet rreth organizimit të Javës për ndryshime klimatike, në

bashkëpunim me REC dhe MMPH;

- ☐ Një ndër aktivitetet e planifikuara më të rëndësishme për vitin 2021, ka qenë vendosja e shenjave të komunikacionit dhe emërtimin e rrugëve publike në komunën e Istogut.
- ☐ Këtë vit ka qenë e planifikuar që përmes një analize më të thellë të lëndëve, ligjeve në fuqi dhe përmes një pune të palodhshme, të arrihet më shumë në ngritjen profesionale të nëpunësve të Sektorit të shërbimeve të përbashkëta, në mënyrë që të evitohen gabimet e kaluara në përpilimin e vendimeve të këtij organi.

Aktivitetet e implementuara:

- ☐ Publikimi i Udhëzuesit për qytetarë;
- ☐ Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete;
- ☐ Publikimi i lejeve ndërtimore në web-faqen e Komunës;
- ☐ Mbikëqyrja e projekteve që realizohen nga investimet kapitale të Komunës;
- ☐ Pjesëmarrje aktive në hartimin e HZ dhe kordinim;
- ☐ Mbikëqyrja projekteve të DPUM;
- ☐ Mbikëqyrja e 7 kontratave të investimeve të Komunës;
- ☐ Mbikëqyrja e planeve rregulluese të Komunës (Ndryshimi dhe plotësimi i Planit rregullues
- ☐ Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve të ndërtuara për objektet në pronësi shoqërore;
- ☐ Bartja-inkorporimi i këtyre të dhënave;
- ☐ Futja në përdorim i të dhënave për lëndët, dedikuar vetëm për sektorin e legalizimit;
- ☐ Implementimi i data-bazës elektronike të brendshme për kërkesat për legalizim, ankesa, kërkesa të ndryshme dhe arkivimit (kontroll i brendshëm i procesit të lëndëve, sistem qendror);
- ☐ Shtypja e materialit informues dhe pranimi i tyre (fushata sensibilizuese), siç janë: fletëpalosjet, aromatizuesit, doorhanger, stikersat, panotë në format A0, A1 dhe A2, billboardat;
- ☐ Shpërndarja e materialit informues në bazë të planit dinamik, siç janë: fletëpalosjet; aromatizuesit; dooranger; billboardat; panot në formatin A0, A1 dhe A2;
- ☐ Shpërndarja e kërkesave për regjistrim të protokolluar të ndërtimeve pa leje në zonat rurale, të cilat i kemi regjistruar në terren me iniciativë të Sektorit të legalizimit;
- ☐ Pranimi i stafit shtesë në lëmenjtë përkatës për trajtimin e ndërtimeve pa leje;
- ☐ Legalizimi i objekteve të para;
- ☐ Gjatë kësaj periudhe janë shtuar afërsisht 2.500 m<sup>2</sup> hapësirë gjelbëruese;
- ☐ Rregullimi i parkut të qytetit;
- ☐ Mbjellja e 360 drurëve dekorativë në qytet;
- ☐ Është implementuar në tërësi emërtimi i rrugëve dhe vendeve të tjera publike në komunën e Istogut, ku për këtë periudhë, komisioni ka propozuar 3 emërtime dhe 6

propozime për listën rezervë;

- ☐ Projekt propozimi për shfrytëzimin e Zonës industriale në Istog;
- ☐ Hulumtim dhe analiza rreth projekteve të disa bashkësive lokale dhe disa çerdheve;
- ☐ Lista e lejeve, kushteve dhe pëlqimeve të lëshuara nga kjo drejtori;

Aktivitetet në implementim e sipër:

- Vazhdohet me zbatimin e bazës ligjore, duke u përpjekur që të respektohen afatet ligjore;
- Po punohet në përmirësimin e sistemit të informimit për monitorimin e procedurës së marrjes së lejes së ndërtimit nga qytetarët, si masë e transparencës;
- Po punohet në funksionalizimin e skemës së re të ristrukturuar të stafit, ashtu që të bëhet e ditur ndarja e përgjegjësisë;
- Po bëhen përgatitjet për funksionalizimin e grupit, i cili do të merret me trajtimin e lëndëve që konsiderohen si të komplikuar dhe nevojitet inputi i më shumë zyrtarëve;
- Po punohet në zgjidhje të ndryshme urbane, deri në miratimin e tyre;
- Po vazhdon publikimi i të gjitha lejeve të lëshuara ndërtimore nga Sektori i urbanizmit, duke punuar me kronologji nga lejet më të fundit;
- Vazhdimisht janë duke u identifikuar pengesat në zbatim të planeve;
- Gjatë periudhës shkurt - nëntor, do të përfundojë zbatimi i projektit për parkun e qytetit.

Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për

periudhën raportuese Të hyrat nga lejet e

ndërtimit:

| Të hyrat e planifikuara | Të hyrat e realizuara | %     | Obligimet e mbetura për vitin 2021 | Borxhet e përgjithshme | Janë dhënë leje m <sup>2</sup> |
|-------------------------|-----------------------|-------|------------------------------------|------------------------|--------------------------------|
| 150.000,00              | 118.620,00            | 79.08 |                                    |                        |                                |

Diskutimet publike / takimet me qytetarë:

Për shkak të pandemisë janë shmang pothuaj të gjitha diskutimet me qytetarët, me qëllimin vetëm për mbrojtjen e shëndetit publik.

Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër:

| Nr. | Përshkrimi i lëndës                                  | Numri i lëndëve të trajtuara Gjithsej: |
|-----|------------------------------------------------------|----------------------------------------|
| 1   | Aktpërcjellës                                        | 22                                     |
| 2   | Aktvendim kompensimi (për leje ndërtimi)             |                                        |
| 3   | Caktim i pikave të ndërtimit                         | 7                                      |
| 4   | Caktim i vijës rregulluese                           | 27                                     |
| 5   | Dispozita urbanistike                                | 14                                     |
|     | Dërgesë dokumentacioni                               |                                        |
| 5   | Pranime të projekteve për infrastrukturë             |                                        |
| 6   | Garanci bankare - pagesa për leje                    |                                        |
| 7   | Informime për çështje të ndryshme urbane             | 24                                     |
| 8   | Informime nga Plani (PZhU, PRrU)                     | 12                                     |
| 8   | Interpretime ligjore                                 | 1                                      |
| 9   | Kërkesa nga DPUM nga institucionet tjera             | 7                                      |
| 10  | Konkluzione të ndryshme për përmirësime të vendimeve | 2                                      |
| 11  | Konstatime të situacionit                            |                                        |
| 12  | Kushte ndërtimore                                    | 20                                     |
| 13  | Komisione                                            | 2                                      |
| 14  | Leje të përkohshme                                   |                                        |
| 15  | Leje mjedisore komunale                              | 8                                      |
| 16  | Leje ndërtimi - Infrastrukturë                       | 3                                      |
| 17  | Leje ndërtimi                                        | 84                                     |
| 18  | Leje përdorimi                                       | 4                                      |
| 19  | Leje rrënimi                                         | 2                                      |
| 20  | Njoftime publike                                     | 12                                     |
| 21  | Pëlqime për bashkim të parcelave                     |                                        |
| 22  | Parcelime                                            |                                        |
| 23  | Pëlqime të ndryshme (ndërtim/renovim/rrethojë)       | 10                                     |
| 24  | Pëlqime për infrastrukturë                           | 14                                     |
|     | Kontrollim të projekteve                             |                                        |
| 23  | Plotësime dokumentacioni                             | 0                                      |
| 24  | Refuzime                                             | 12                                     |

|          |                                               |     |
|----------|-----------------------------------------------|-----|
| 25       | Renovime                                      |     |
| 26       | Ndërrim destinimi                             | 1   |
| 27       | Tërheqja e lëndës nga pala                    |     |
| 28       | Vendime të tjera (pezullim i vendimit)        |     |
| 29       | Vërtetim për dëme lufte                       |     |
| 30       | Zgjidhje urbane                               |     |
| 31       | Numri i lëndëve të pranuar në këtë periudhë   |     |
| 32       | Numri i lëndëve të trajtuara në këtë periudhë |     |
| 33       | Vendim për kompensim                          |     |
| 34       | Konkluzion                                    | 15  |
| 35       | Qasje në dokumente zyrtare                    |     |
| 36       | Kërkesa për kthim të parave                   |     |
| 37       | Legalizime                                    | 128 |
| 38       | Numri i lëndëve në trajtim e sipër            |     |
| Gjithsej |                                               | 431 |

### Sektori i legalizimit

- Është siguruar numri i zyrtarëve profesionist, sfidat që presin ekipin tonë të zyrtarëve janë të mëdha dhe së kërkon staf të përgatitur mirë në aspektin profesional;
- Trajnimi i stafit sipas konditave dhe standardeve më të reja, të cilat do të aplikohen në përdorimin e programit të caktuar dhe të avancuar për aplikim trajtim, të kërkesave në trajtim të ndërtimeve pa leje, në bashkëpunim me MIA-në dhe programit mbështetës të USAID-it.

### AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

- Zbatimi i rregullativës ligjore në fuqi dhe afateve ligjore të përcaktuara në procedurën e shqyrtimit dhe të vendosjes për kërkesat për ndërtimet pa leje, të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara, të kategorisë I dhe të kategorisë II, të cilat janë shtëpi, ndërtimet pa leje të përfunduara dhe substancialisht të përfunduara, të kategorisë II, të cilat nuk janë shtëpi.
- Ndërtimet pa leje të papërfunduara të kategorisë I dhe të kategorisë II, të cilat janë shtëpi, dhe ndërtimet pa leje të papërfunduara të kategorisë II, të cilat nuk janë shtëpi.
- Caktim të kushteve ndërtimore për dhënien e Lejes për legalizim dhe përfundim të ndërtimit, të kërkesave tjera;
- Zbatimi i rregullave të vendosura dhe qëndrimeve të marra në takimet e mbajtura në aspektin e eliminimit dhe procedurave të panevojshme, po ashtu edhe në reduktimin e

- kohës së nevojshme për përfundimin e atij procesi;
- Riorganizimi e punës në Zyrën shërbyese, One Stop Shop, e cila duhet të funksionon në kuadër të Sektorit të urbanizmit dhe legalizimit të kësaj drejtorie;

***Gjatë e vitit 2021 nga Sektori për Mbrojtje të mjedisit janë realizuar këto detyra:***

Gjatë vitit 2021 janë parashtruar 10 kërkesa, Janë lëshuar 8 Vendime për LMK tri kërkesa për LMK është kthyer përgjigjeje për anulim , 8 procesverbale, njoftime, sipas detyrës zyrtare. Dy kërkesa u është kthyer përgjigja me shkrim ,Lëshimin e një referencë qe është kërkuar. Bashkëpunimin me studentet e Inxhinieres kompjuterike te cilët janë kanë praktikantë ne zyrën tone , ku kemi asistuar edhe ne provimin e tyre te praktikës. Një punë e rëndësishme që është përfunduar me sukses ka qen puna qe është kryer për punimin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor VSM për Harta zonale , ku me Vendim te Ministrisë jemi Njoftuara për miratim te VSM për HARTA Zonale , Zhvillimi me sukses i Aksionit ne pastrimin e deponive ne komunën se Istogu, Pjesëmarrja në aksionin “Ta pastrojmë Kosovën .

Realizimin e disa punëtorive me Organizatën për zhvillim te komuniteteve Bashkëpunimi me UNDP –Dialogu ndërkufitar për mes trashëgimisë kulturore dhe natyrore . Zbatimi dhe monitorimi ,raportime Agjendës 2030 dhe OZHQ-ve . Njëherit kemi qenë pjesëmarrës në disa Komisione për probleme të natyrës mjedisore, në bashkëpunim me Inspektorët Komunal dhe të Drejtorive Komunale si Drejtorinë për Bujqësi dhe atë për Zhvillim Ekonomik , të gjitha këto në bazë të detyrës zyrtare. Prezantime për VSM TE Harta Zonale Diskutime Publike dhe proceduar e parapara ne bazë te Ligjit për VSM. Bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ministrin e Pushtetit Lokal ka qenë në nivel për plotësimin e formularëve të ndryshëm dhe ofrimin e të dhënave nga sektori mjedisor . Shuma e përgjithshme e taksës së paguar për Leje Mjedisore Komunale për vitin 2021 është **10936 €**



## Republika e Kosovës

Republika Kosova  
Republic of Kosovo



## Komuna Istog

Opstina Istok  
Municipality Istog

**Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim** / Direkcijaza Javne Usluge, Odbranu I spasavanje / Department of Public Services,  
protection and Rescue

Nr.890/2021

Datë: 31.12.2021

Në kuadër të Drejtoratit për Shërbime publike, Mbrojtje dhe Shpëtim funksionojnë këto sektorë: Sektori i Shërbimeve Publike dhe sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor-2021 në Drejtoratin për Shërbime publike, Mbrojtje dhe Shpëtim nga ana e palëve gjegjësisht nga qytetarët na janë parashtruar gjithsejtë 1022 kërkesa nga ato kërkesa janë :

- Të miratuara 494
- Të refuzuara 511
- Hedhur poshtë 2
- Anuluar 8
- Në Proces 6
- Pzulluar 1
- TOTALI: 1022

Kërkesat e parashtruara nga palët, gjegjësisht qytetarët janë të natyrave të ndryshme dhe atë për:

Licencë Auto-Taxi,



Kërkesa për furnizim me gypa te ujësjellësit dhe kanalizimit,  
Kërkesa për furnizim me material ndërtimor për raste emergjente,  
Kërkesa nga lëmia e komunikacionit (transport , sinjalizim),  
Kërkesa për furnizim me Zhavorr ,  
Kërkesë për prerje Asfalti,  
Kërkesa për masat mbrojtëse nga zjarri  
Kërkesa për kryerjen/mos kryerjen e shërbimit ushtarak  
Kërkesa për furnizim me ujë të pishëm, kërkesa për strehim dhe ndihmë në ndërtimin e shtëpive etj.

#### **SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE:**

Gjatë kësaj periudhe vjetore bazuar ne kërkesat e qytetareve kemi dal në teren duke shqyrtuar dhe analizuar te gjitha rastet varësisht prej mundësive buxhetore ju kemi dal në ndihmë duke u bazuar në kontratat e aktiviteteve të ndryshme të cilat përmbushin edhe kërkesat e qytetareve qofshin ato furnizim me zhavorr, furnizim me material ndërtimor, furnizim me gypa te ujësjellësit dhe kanalizimit etj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe vjetore është përgatitur dokumentacioni me kohë për shpalljen e të gjithë tenderëve të paraparë në plan buxhetin e vitit 2021 për DSHPMSH, **dhe janë realizuar këto projekte:**

- Mirëmbajtja e projekteve infrastrukturore (40,000.00€),
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik (20,000.00€),
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Istog (35,000.00€),
- Ndertimi i ndriçimit publik ne Tomoc ( 15,000.00€)
- Ndertimi i ndriçimit publik ne Cerrcë ( 24,000.00€)
- Ndertimi i ndriçimit publik ne Banjë ( 10,000.00€)
- Ndërtimi i kanalizimit në Dragolefc (60,000.00€),
- Ndertimi i kanalizimit ne Corollukë ( 18,000.00€)
- Ndertimi i kanalizimit ne fshatin Kosh ( 25,000.00€)
- Ndertimi i kanalizimit ne Kerrninë te eperme ( 45,000.00€)
- Ndertimi i kanalizimit ne Saradran (22,000.00€)

- Blerja dhe furnizimi me gypa te kanalizimit dhe ujësjellësit (47,800.00€).
- Sinjalizimit Horizontal dhe vertikal (30,000.00€),e pa realizuar-lenda ne OSHP
- Sanimi i gjendjes nga fatkeqësitë natyrore (50,000.00 €),
- Ndërtimi i mureve mbrojtëse dhe urave (35,000.00€),
- Ndërtimi i deponisë në Tuqep (25,000.00€),
- Trasimi i rruges Ahmet Rugova dhe krahui 1 (15,000.00€),
- Eliminimi i mbeturinave nga hapësirat publike (15,000.00€),
- Mirëmbajtja e rrugëve lokale te rendit të IV-të (20,000.00€),
- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale të asfaltuara (16,000.00€),
- Vazhdimi i kanalizimit ne Lubovë per lidhje me impiantin ekzistues (40,000.00€),
- Mirëmbajtja e kamerave (10,000.00€)
- Dezinfektimi i hapësirave publike, (20,000.00 ),
- Trajtimi i qeneve endacak (15,000.00€)
- Rregullimi i varrezave te qytetit ( 25,000.00€)
- Dislokimi dhe riinstalimi i kabullit optik ne qytetin e Istogut(5,500.00€)

Po ashtu ne aspektin profesional ne si sektor kemi qenë të kyçur në kryerjen e shumë projekteve-paramasa dhe parallogarit, gjithashtu kemi qenë të kyçur në komisione për vlerësimin e tenderëve tjerë, si dhe në mbikëqyrje të projekteve të ndryshme dhe në verifikime të punimeve për projekte të te drejtorisë se SHPMSh dhe drejtorive tjera ne kuadër te Komunës

Po ashtu ne këtë periudhë vjetore është bërë trajnimi për grumbullimin dhe futjen e te dhënave ne softuerin ENMASOFT nga AKEE dhe GIZ vazhdim i projektit.

Janë mbledhur te dhënat e objekteve te komunës te cilat konsumojnë energji ,te dhënat janë futur ne softuerin ENMASOFT

Ne bashkëpunim me GIZ ,Komuna e Istogut dhe Asociacioni i Komunave te Kosovës për disa muaj prapë janë angazhuar dy praktikant profesional për te futur te dhënat ne sistem .GIZ ka te angazhuar një kompani konsulentë qe po ndihmon ne grumbullimin e te dhënave te objekteve te Komunës se Istogut te dhënat kanë vazhduar te vendosen ne një pyetësor qe mandej këto te dhëna regjistrohen ne softuerin ENMASOFT

Te dhënat qe përpunohen janë : te dhënat klimatike ,te dhënat themelore për ndërtesën ,te dhënat ndërtimore,ngrohja,përgatitja e ujit sanitar,kondicionimi i ajrit,ndriçimi.

Te gjitha ndërtesat janë te ndara ne :institucione administrative ,ndërtesa për veprimtari arsimore, ndërtesa për veprimtari shëndetësore , ndërtesa për veprimtari kulturore , ndërtesa e kujdesit sociale ndërtesa për veprimtari sportive .

Ne komune e Istogut janë të regjistruar 61 ndërtesa të komunës që konsumojnë energji konsumi i energjisë është në ngrohje ,në energji elektrike,ndriçim ,uji i rrjedhshëm dhe karburant të automjeteve që menaxhohen nga komuna

Deri tani janë grumbulluar të dhënat dhe janë futur në sistem për konsumin e energjisë elektrike për tri vitet e fundit 2016,2017,2018 në 61 objekte të komunës dhe të ndriçimit publike që janë në 98 njehtor elektrik. Kjo punë është arritur duke pasur qasje online në KEDS në kemi hapur llogari në email në kompaninë për shpërndarjen e energjisë KEDS dhe marrim të dhëna për çdo njehtor të energjisë elektrike të objekteve komunale si shkolla çerdhe dhe kopshte, ndërtesa administrative, kulturore ,sportive ,shëndetësore dhe ndriçimin publik .

Janë grumbulluar të dhënat për konsumin e ujit të rrjedhshëm për të gjitha objektet të komunës së Istogut me 88 njehtor të ujit ,këto të dhëna merren në formë në letër nga KUR Hidro Drini e të gjitha këto janë futur në ENMASOFT për vitet 2016,2017,2018.

Janë grumbulluar të dhënat për konsumin e energjisë për ngrohje për të gjitha objektet ndërtesat komunale të lendeve djegëse dru,nafte,pelet,energji elektrike për vitin 2016,2017 dhe 2018

Përveç të dhënave që kemi duke i futur në sistem në të njëjtën kohë me bashkëpunim me GIZ dhe kompaninë konsulente kemi duke përgatitur PVEE për komune e Istogut është formuar grupi i punës nga Kryetari për hartimin e PVEE .

Kemi bërë trajnime të vazhdueshme për përdorimin e softuerit dhe të përgatitjes së raporteve për menaxhimin e energjisë

Prej të gjitha aktiviteteve e deri tanishme kemi përgatitur Planin Komunal për Eficiencë të Energjisë

I cili dokument është miratuar në Kuvendin Komunal të Istogut.

### **Spektori për Mbrojtje dhe Shpëtim**

Spektori i Emergjencave ka bashkëpunuar me Drejtorate nëfazën e planifikimit buxhetor për vitin 2020 dhe ka kontribuar në planifikimin e projekteve qëndikojnë nëfatkeqsi natyrore me Drejtoratin e Bujqësis, Drejtoratin e Arsimit SHPMSH dhe Zyren Lokale të Komuniteteve. Janë Planifikuar gjithsejtë 13 projekte që ndikojnë në parandalimin e fatkeqsive, lehtësojnë intervenimin nëfatkeqsi apo ndihmojnëanimin e gjendjes post emergjente.

- ❖ Plani i Gatishmërisë Emergjente i cili ështëbaz për hartimin e Planit Operativ Emergjent është plotësuar me shënime të reja siç janë shënimet nga institucionet e Arsimit dhe Shendetsis.
- ❖ Plani Operativ Emergjentështë hartuar dhe plotsuar nëmas prej 90% , kanë mbetur specifikat e detyrave të Drejtorive dhe të Kryetarit të Komunës në raste të fatkeqësive më të mëdha për vijimsin e pushtetit. Permesemailit zyrtar disa her janë njoftuar Drejtoret e Drejtorateve si dhe Kryetari por që nuk më janëpergjigjur nëkerkes për plotsimin e shenimeve, andaj me këto mungesa nuk mund të qitet para Kuvëndit komunal për miratim. Mos miratimi i Planit Operativ Emergjent rrezikon qëvlersimi i performances nga MAPL sektorin e Emergjencave të Komunës Istog ta vlersoj me zero pikë.

- ❖ Plani në rast tërmeti është bërë grumbullimi i shënimeve të familjeve që banojnë në ndërtesa shumë kateshe ku pason hartimi i planit për strehim dhe evakuim në rast rreziku.

Po ashtu lidhur me hartimin e këtij plani problem në vazhdim paraqet mungesa e akteve normative dhe mungesa e hapësirave për strehim.

- ❖ Është bërë evidentimi i mjeteve për reagim emergjent në komunën tonë me shënime të duhura neper firmat e nevojshme me qëllim të angazhimit të teknikes sipas nevojë dhe sipas rasteve në mënyrë që mundësisht mos të ketë nevojë lëvizje e makinerisë në relacione të gjata por të jenë në afërsi për intervenim në vendin e ngjarjes. Problem në këtë fushë paraqet mungesa e Udhëzimit Administrativ për mënyrën dhe nivelin e kompensimit të kompanive të angazhuara si dhe nënshkrimi i Marrveshjes së mirkuptimit. Megjithatë marrveshjet e mirkuptimit(stendbaj) mund të nënshkruhen me klauzulë se kompenzimi për angazhim do të bëhet proporcionalisht me çmimin e tregut në ditën e angazhimit në intervenim. Buxheti personanimin e gjendjes nga fatkeqësit natyrore është i planifikuar me Ligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2020.

- ❖ Sektori është përgjigjur kërkesave të qytetarëve me shkrim siç janë: lëshimi i certifikatave mbi shërbimin ushtarak, vërtetimi për plotësimin e kushteve për mbrojtje nga zjarri, vërtetime në raste të djegjes së shtëpisë apo pronë personale, ndihma për shtëpi dhe pullaze etj.

- ❖ Në kuadër të zyrës për alarmim dhe informim është përpunuar plani për mbulimin e territorit të komunës sonë me radio rrjetë. Në mungesë të mjeteve materiale nuk ka mundur të realizohet ky projekt. Problem të madhë paraqet komunikimi, sistemi dhe gjendja e radiolidhjeve nuk funksionon fare. Është më se e nevojshme që të ndërmerren masa për të aktivizuar sistemin në tërësi.

- ❖ Shefi i Sektorit për mbrojtje dhe shpëtim përpos detyrave në kuadër të sektorit është i angazhuar edhe në kuadër të Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSB-së) në realizimin e projekteve në bashkëpunim me UNDP-në, me qendrën për informim dhe siguri si dhe në organizimin e mbledhjeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, komisioni për të zhdukur, Shërbimin Sprovues të Kosovës për monitorimin e të denuarve me punë në dobi të përgjithëshme e që gjatë këtij viti i kemi pasur katerraste, me gjithësejt 360 orë pune në dobi të përgjithëshme. Deri me tani këta persona janë angazhuar në shkollë dhe çerdhenë pas rritjes të vorrezave etj.

- ❖ Shefi i Sektorit për mbrojtje dhe shpëtim gjatë pandemis mars-dhjetor ka mbuluar të gjitha detyrat që dalin për Qendrën Operative Emergjente lokale dhe i është përgjigjur kërkesave të qytetarëve edhe jashtë orarit të punës për lëshimin e lejeve të udhëtimit brenda territorit të Kosovës duke rrezikuar shëndetin personal dhe familjar nga Covid19 e që nuk është kompenzuar për punjashtë orarit dhe rrezikshmeri

❖

Për arsye të pensionimit të zyrtarit për Planifikim nga marsi 2020 dhe vdekja e zyrtarit për informim dhe alarmim, e mos mbulimi i vendit të punës me staf të ri, Sektorit për Mbrojtje dhe Shpëtim i janë vështirësuar përmbushja e obligimeve bazuar në legjislacionin në fuqi. Në si sektor bazuar edhe në përshkrimin e detyrave të punëve kemi qenë të angazhuar në kryerjen e detyrave bazuar në kërkesat e qytetarëve, si dhe kemi kontribuar në hartimin e projekteve të ndryshme nga lista e projekteve të parapara për këtë vit.

Në vijim bashkangjitur është edhe raporti i NjPZSH-së

PASQYTRA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË ZJARREVE: **JANAR - DHJETOR 2021**

| Realizimi I numrit te pergjithshem te daljeve ,struktura e zjarreve dhe int. tjera Janar-Dhjetor 2021 |                                        |                      |                      |                            |                              |              |                     |            |          |             |           |          |             |              |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------|----------------------|----------------------|----------------------------|------------------------------|--------------|---------------------|------------|----------|-------------|-----------|----------|-------------|--------------|
| 2021                                                                                                  | Nr.i<br>përg<br>j.<br>i<br>dalje<br>ve | Nr.i<br><br>zjarreve | Nr. i<br><br>Teknike | Nr.i<br><br>shërbim<br>eve | Akside<br>nte<br>rrugor<br>e | Vërshi<br>me | Të<br><br>rej<br>sh | Të lënduar |          |             | Të vdekur |          |             | Giths<br>ejt |
|                                                                                                       |                                        |                      |                      |                            |                              |              |                     | zj<br>.    | qy<br>t. | t<br>o<br>t | zj.       | qy<br>t. | t<br>o<br>t |              |
| Janar                                                                                                 | 25                                     | 8                    | 6                    | 0                          | 0                            | 11           | 0                   | 0          | 3        | 3           | 0         | 0        | 0           | 25           |
| Shkur<br>t                                                                                            | 13                                     | 12                   | 1                    | 0                          | 0                            | 0            | 0                   | 0          | 0        | 0           | 0         | 0        | 0           | 13           |
| Mars                                                                                                  | 19                                     | 15                   | 4                    | 0                          | 0                            | 0            | 0                   | 0          | 0        | 0           | 0         | 0        | 0           | 19           |
| Prill                                                                                                 | 10                                     | 8                    | 1                    | 0                          | 1                            | 0            | 0                   | 0          | 4        | 4           | 0         | 0        | 0           | 10           |
| Maj                                                                                                   | 18                                     | 14                   | 1                    | 2                          | 1                            | 0            | 0                   | 0          | 2        | 2           | 0         | 0        | 0           | 18           |
| Qersh<br>or                                                                                           | 10                                     | 3                    | 2                    | 4                          | 1                            | 0            | 0                   | 0          | 4        | 4           | 0         | 0        | 0           | 10           |
| Korrik                                                                                                | 23                                     | 13                   | 2                    | 5                          | 3                            | 0            | 0                   | 0          | 3        | 3           | 0         | 0        | 0           | 23           |
| Gusht                                                                                                 | 79                                     | 73                   | 2                    | 4                          | 0                            | 0            | 0                   | 0          | 0        | 0           | 0         | 1        | 1           | 79           |
| Shtato<br>r                                                                                           | 29                                     | 24                   | 2                    | 1                          | 1                            | 1            | 0                   | 0          | 2        | 2           | 0         | 0        | 0           | 29           |
| Tetor                                                                                                 | 6                                      | 6                    | 0                    | 0                          | 0                            | 0            | 0                   | 0          | 0        | 0           | 0         | 0        | 0           | 6            |
| Nënto<br>r                                                                                            | 9                                      | 7                    | 0                    | 1                          | 0                            | 1            | 0                   | 0          | 0        | 0           | 0         | 0        | 0           | 9            |
| Dhjetor                                                                                               | 4                                      | 1                    | 1                    | 0                          | 1                            | 1            | 0                   | 0          | 1        | 1           | 0         | 0        | 0           | 4            |
| Gjiths<br>ejtë                                                                                        | 245                                    | 184                  | 22                   | 17                         | 8                            | 14           | 0                   | 0          | 19       | 19          | 0         | 1        | 1           | 245          |

**Forma tabelore e rasteve te zjarreve për te cilat janë punuar raportet përkatëse dhe është bërë vend shikimi e rastit, 2021**

| Nr, data.                                                 | Pronari                                                         | Shtëpi /<br>biznes | Obj.<br>percjellëse | Te tjera ( ushqim<br>bagëti dhe<br>prod.bujq.<br>vetura), etj. | Shkak I zjarrit.                                                                                       | Dëmet                                                                                  | Shenime                                                      |
|-----------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------|--------------------|---------------------|----------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------|
| <b>Date : 04.01.<br/>2021</b><br><br><b>Nr: 001 / '21</b> | <b>Qirko Rapanoviq.</b><br>„Prepranjska” nr; 32.<br>Osojan      | Shtëpi<br>banimi   | /                   | /                                                              | Probleme me<br>instalim, shtëpi<br>donacionesh,<br>prania e brejtesve,<br>rrjeti i dobët<br>furnizues. | Te vogla,<br>njehsor dhe<br>instalim<br>elektrik.                                      |                                                              |
| <b>Date : 11.01.<br/>2021</b><br><br><b>Nr: 002 / '21</b> | <b>Blerta (Demir) Hakaj.</b><br>Rr. „Qazim Hakaj”<br>Orroberdë, | /                  | /                   | Veturë                                                         | Zjarrvënije,<br>dyshimet e para<br>janë zjarrvënije                                                    | Vetura Golf V+,<br>dizel, është<br>djegur terësisht                                    |                                                              |
| <b>Date : 13.01.<br/>2021</b><br><br><b>Nr: 003 / '21</b> | <b>Tahir Elshanit .</b>                                         | /                  | /                   | vershim ne<br>rezervuaret e<br>naftes                          | /                                                                                                      |                                                                                        | Për shkak te<br>reshjeve te<br>medha ka<br>depertuar<br>uji. |
| <b>Date :17.01.<br/>2021</b><br><br><b>Nr: 004 / '21</b>  | <b>Avdullah (Malë)<br/>Osmanaj.</b><br>„Sylë Çeta” nr; 100.     | Shtëpi<br>banimi   |                     | /                                                              | Nxemësja<br>elektrike e harruar<br>nga femiu I<br>pronarit.                                            | Një dhomë me<br>orendit e sajë, 3<br>dyer, instalim<br>elektrik nxirje<br>nga tymi.... |                                                              |

|                                                 |                                                                          |               |                                                   |                                          |                                                                                         |                                                                                   |                                                                                       |
|-------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------|---------------|---------------------------------------------------|------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
|                                                 |                                                                          |               |                                                   |                                          |                                                                                         |                                                                                   |                                                                                       |
| <b>Date :19.01.2021</b><br><b>Nr: 005 / '21</b> | <b>„ MACON” SH.P.K në Cerrcë.</b>                                        |               |                                                   | Stabilimente elektrike                   | Temperaturat e ulëta kan bërë qe kabllojt te tkurren dhe te kputen, mungesë tolerance   | Është djegur instalim elektrik dhe nje arkë ( orman) me stabilimente              |                                                                                       |
| <b>Date :22.01.2021</b><br><b>Nr: 006 / '21</b> | <b>Shemsedin dhe Jeton Imeraj.</b><br>Padalishtë<br>„ Avdi Uka ” nr; 22. | Shtëpi banimi | /                                                 | /                                        | Rast I dyshimt, mund te jet edhe nga elektrika por edhe zjarrvënije, mbetet te hetohet. | Gjysma e shtëpisë, pjesa veriore, një dhomë me orënditë e sajë.                   | shtëpia banohej nga dy familje, një ka emigru ne Francë, pronaret e pjesës se djegur. |
| <b>Date :08.02.2021</b><br><b>Nr: 007 / '21</b> | <b>El Clasico Arena në Gurrakoc,</b><br>Nexhmedin Ferataj.               | /             |                                                   | Fushë sportive, futbolli                 | defect elektrik ne kutinë shperndarëse.                                                 | Dëmët jan te vogla.                                                               |                                                                                       |
| <b>Date :29.02.2021</b><br><b>Nr: 008 / '21</b> | <b>Daut Ferataj</b><br>Rr; „Ibish Tali: nr 63<br>Uçë                     | /             |                                                   | Zjarrë I Hapur, masë drunore industriale | Moskujdesi, është ndezë një zjarrë për pastrim dhe ka dalë nga kontrolli                | Masë drunore( dërrasa) 4m <sup>3</sup> , xhama te objektit instalimi qe kalon,... |                                                                                       |
| <b>Date :19.05.2021</b><br><b>Nr: 009 / '21</b> | <b>Sahit (Sadik) Qetinaj</b><br>Lubozhdë, Rr; Mirsad Idrizaj.            |               | Object përcjellës, kuzhinë verore, magaze gjërash |                                          | Shporeti ka pasur te improvizuar një oxhak nga çynga llamarine                          | Dëme te konsiderueshme                                                            | Neglizhim i situates                                                                  |
| <b>Date :09.06.2021</b>                         | <b>Isuf (Hysen ) Kabashi</b><br>Rr; Niman Kabashi Nr                     | /             | Garazhë pune                                      |                                          | Instalimi, kablloja furnizuese e                                                        | Garzhi, Vegleri pune, dritaret                                                    |                                                                                       |

|                                           |                                                             |   |                                 |   |                                                                                    |                                         |                                        |
|-------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|---|---------------------------------|---|------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------|----------------------------------------|
| Nr: 010 / '21                             | 50. Gurrakoc                                                |   |                                 |   | garazhit e<br>ekzekutuar<br>joprofesionalisht<br>me shum<br>vazhdime               | plastike te<br>shtëpisë, kan<br>krisur. |                                        |
| Date :28.06.<br>2021<br><br>Nr: 011 / '21 | Arben Alimetaj<br>Muzhevinë, në Rr;<br>„Avdyl Jahaj”, nr 50 | / | Garazhë dhe<br>ahur<br>bagëtije | / | Pranija e brejtësve,<br>shpendesve dhe<br>dëmtimi I<br>kablllove te<br>instalimit. | Dëmet janë të<br>konsiderueshme<br>.    | Instalimi<br>elektrik<br>joprofesional |

|                                                 |                                                                             |   |               |                                               |                                                               |                                               |                                                     |
|-------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------|---|---------------|-----------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------|-----------------------------------------------------|
| Date<br>:01.07.<br>2021<br><br>Nr: 012 /<br>'21 | Azllan ( Selman) Veselaj<br>Syriganë(Suhogerllë), në Rr;<br>„Januz Seferaj” |   | Ahur bagëtije | /                                             | Instalim<br>joprofesional,<br>pranija e<br>brejtësve          | Ushqim bagëtije<br>objekti, makineri<br>pune. |                                                     |
| Date<br>:12.07.<br>2021<br><br>Nr: 013 /<br>'21 | Familja Komatina<br>Dobrushënë Rr; „Isuf<br>Visoqi”                         | / | /             | Zjarrë fushorë,                               | dyshohet<br>zjarrvënije                                       | Humullishte,<br>shkurre mexha, etj            |                                                     |
| Date<br>:03.08.<br>2021<br><br>Nr: 014 /<br>'21 | 02 deri me 04 Gusht 2021 në<br>komunen e Istogut                            | / | /             | Zjarrë fushorë,<br>8raste të<br>evidentuara   | rrjeti I dobët<br>elektrik, si<br>dhe<br>zjarrvënije          | Dëme të<br>konsiderueshme                     | Zjarrvënije nga<br>keqëbërës.                       |
| Date<br>:06.08.<br>2021<br><br>Nr: 015 /        | 05 Gusht 2021, zjarre në<br>komunen e Istogut                               | / | /             | Zjarrë fushorë, 15<br>raste të<br>evidentuara | Zjarrvënije,<br>rrjeti elektrik,<br>deponija e<br>mbeturinave | Dëme të<br>konsiderueshme                     | mot me erë, dhe<br>temp të larta,<br>deponija Tuqep |



|                                                                      |                                                                                    |                                      |                   |                                     |                                                                                      |                                                               |                                   |
|----------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------|-------------------|-------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------|-----------------------------------|
| '21                                                                  |                                                                                    |                                      |                   |                                     |                                                                                      |                                                               |                                   |
| <b>Date</b><br>:08.08.<br>2021<br><br><b>Nr: 016 /</b><br><b>'21</b> | <b>Berisha në Saradran.</b><br>„8 Maji” nr 251,                                    | /                                    | /                 | Zjarrë fushorë,<br>Fidane paulonije | Kabloja<br>furnizuese e<br>hidroforit, me<br>e hollë se sa<br>duhet                  | rreth 1ha fidane<br>paulonije.                                | Neglizhim situatë                 |
| <b>Date</b><br>:12.08.<br>2021<br><br><b>Nr: 017 /</b><br><b>'21</b> | <b>„DINI-B”, me pronarë</b><br><b>Lulzim Blakaj.</b><br>„Deshmoret Dervishaj”      | /                                    | Object biznesi    | /                                   | Zjarr I<br>shkaktuar<br>adapter<br>kamerash dhe<br>paisjeve të<br>alarmit            | dëmet të<br>konsiderueshme                                    | Mosmirëmbajtje e<br>instalimeve . |
| <b>Date</b><br>:31.08.<br>2021<br><br><b>Nr: 018 /</b><br><b>'21</b> | <b>Ramiz (Ukë) Metaj nga</b><br><b>Bellopoja</b>                                   | /                                    | /                 | Zjarrë fushorë                      | Pasojë e zjarrit<br>nga deponija<br>e në tuqep,<br>pasojë e<br>zjarreve<br>05.08.'21 | Mal jo I rritur<br>rreth 05ha,<br>humullishte<br>rreth 1.5 ha |                                   |
| <b>Date</b><br>:06.09.<br>2021<br><br><b>Nr: 019 /</b><br><b>'21</b> | <b>Asllan (Metush )Rugova</b><br><b>nga Carralluka</b><br>„Lidhja e Pejës”, nr;739 | /                                    | Objekt Përcjellës | /                                   | Rast I<br>dyshimt,                                                                   | Ushqim bagëti ,<br>masë drunore<br>vegla etj                  |                                   |
| <b>Date</b><br>:09.09.<br>2021<br><br><b>Nr: 020 /</b><br><b>'21</b> | <b>Zenel Tafilaj nga Dubrava</b><br>rruga „Valon Myrtaj”                           | /                                    | Object përcjellës | /                                   | si pasojë e<br>mos fikjes së<br>zjarrit të<br>hapur                                  | objekti me orëdit<br>mbrenda, masë<br>drunore.                | Neglizhim I<br>situatës           |
| <b>Date</b><br>:20.09.<br>2021                                       | <b>Izet Haxhijaj nga Rakoshi.</b><br>rruga „Zenun Mustafa” nr; 23                  | Shtëpi, e<br>përdorur<br>vetëm gjatë | /                 | /                                   | Neglizhimi I<br>zjarrit<br>përderisa ka                                              | Dëmet të<br>konsiderueshme                                    | Moskujdesi<br>njerëzorë           |

|                                     |                                               |                                       |   |                                |                                                                       |                                             |                                     |
|-------------------------------------|-----------------------------------------------|---------------------------------------|---|--------------------------------|-----------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------|-------------------------------------|
| Nr: 021 / '21                       |                                               | verës                                 |   |                                | përgaditur turshitë,                                                  |                                             |                                     |
| Date :07.10. 2021<br>Nr: 022 / '21  | Agron (Muharrem) Krasniqit                    | Objekt biznesi, Tharëse çajrash       | / | /                              | Rast i dyshimt, nuk perjashtohet mundësia deshtimit te stabilimenteve | Dy dhoma për tharje, dëme te konsiderueshme |                                     |
| Date : 25.10. 2021<br>Nr: 023 / '21 | Burgut i Dubravës, makinë bujqësore, traktor. | /                                     | / | Makinë bujqësore Traktor       | Është ndezur derisa ishte duke punuar                                 | instalim i traktorit                        |                                     |
| Date : 03.11. 2021<br>Nr: 024 / '21 | Avdyl Mustafaj rruga „Solidariteti”           | Shtëpi, Njehsori elektrik             |   |                                | Problem me njehsoriin elektrik                                        | Njehsori dhe pak instalim                   |                                     |
| Date :15.12. 2021<br>Nr: 025/ '21   | Shkelzen Sejdiqaj, rruga „Ali Fetahu”         |                                       |   | Veturë, BMË me targa 03-210-HD | Problem me sistemin e ftohjes                                         | Te vogla                                    |                                     |
| Date :17.12. 2021<br>Nr: 026/ '21   | Bekim (Ramush) Abazaj, rruga „Fehmi Agani”    | Shtëpi, Tabela e siguresave elektrike |   |                                | Instalim joprofesional, shihen improvizime                            |                                             | manipulim dhe neglizhim I situates. |
| Date :28.12. 2021                   | Palestra e Sporteve ne Istog                  | /                                     | / | Palestren e Sporteve ne Istog  | Zjarrë i shkaktuar nga keqbëres, kan                                  | Rreth 1m² parket karrike etj,..             | Object pa vezhgim.                  |

|                         |                                                                |                                      |  |  |                                          |                                     |                                                       |
|-------------------------|----------------------------------------------------------------|--------------------------------------|--|--|------------------------------------------|-------------------------------------|-------------------------------------------------------|
| Nr: 027/<br>'21         |                                                                |                                      |  |  | hy naten dhe<br>kan qendruar             |                                     |                                                       |
| Date<br>:31.12.<br>2021 | Shefqet Avdiqaj<br>rrugen „Ibrahim Rugova nr<br>50             | Shtëpi dhe<br>biznes në<br>perdhesë, |  |  | Shkak është<br>oxhaku i lënë<br>nën kulm | Rreth 4m <sup>2</sup> kulm          | Neglizhim i<br>instalimeve<br>shtëpiake               |
| Nr: 028/<br>'21         |                                                                |                                      |  |  |                                          |                                     |                                                       |
| Date<br>:30.12.<br>2021 | Ilir (Azem)Kerellaj nga,<br>fshati, Shtupel<br>komuna e Klinës | Shtëpi                               |  |  | instalim<br>joprofesional<br>elektrik.   | Një dhomë me<br>orenditë përkatëse. | Tokëzimi i<br>instalimit nuk është<br>i lidhur fare . |
| Nr: 029/<br>'21         |                                                                |                                      |  |  |                                          |                                     |                                                       |
|                         |                                                                |                                      |  |  |                                          |                                     |                                                       |
|                         |                                                                |                                      |  |  |                                          |                                     |                                                       |
|                         |                                                                |                                      |  |  |                                          |                                     |                                                       |

Naser Gjocaj

\_\_\_\_\_

## KUVENDI I KOMUNËS PËR VITIN 2021

Kuvendi i komunës ka mbajtur 7 (shtatë) mbledhje të rregullta , 2(dy) solemne, si dhe 3 (tri) dëgjime me qytetarë. Pasi që viti 2021 ka qenë vit zgjedhor, kuvendi nuk ka mbajtur mbledhje nga muaji shtator.

Zgjedhjeve lokale të cilat u mbajtën me 14 nëntor 2021. Pas certifikimit Kuvendëve të Komunës, Kuvendi i Komunës së Istogut, thirri mbledhjen Inauguruese me 06 dhjetor 2021, ku të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës (27 anëtar të KK) dhe kryetari i Komunës dhanë betimin (u betuan solemnisht).

Gjatë mbajtjes së këtyre mbledhjeve të kuvendit janë trajtuar dhe shqyrtuar gjithsej 77 (shtatëdhjetë e shtatë) pika të rendit të ditës, duke llogaritur edhe pikat e zakonshme të rendit të ditës, arsyetimi i mungesave në mbledhje, miratimi i procesverbaleve dhe pyetje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës. Për më tepër të gjitha këto pika të rendit të ditës, paraprakisht janë trajtuar dhe shqyrtuar edhe në 10 (dhjetë) mbledhje të Komitetit për Politik dhe Financa për të cilat komiteti ka nxjerrë rekomandime dhe i ka dërguar kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim. Është me rëndësi të thuhet se gati të gjitha rekomandimet e KPF-së dërguar kuvendit për shqyrtim janë mbështetur dhe përkrahur në mënyrë unanime, gjë që tregon një bashkëveprim në mes tyre. Ndërkaq, Komiteti për Komunitete gjatë kësaj periudhe raportuese i ka mbajtur gjithsej 8 (tetë) mbledhje. Në vështrim të pjesëmarrjes së anëtarëve në mbledhjet e thirrura, nuk ka ndodhë asnjëherë që për shkak të mungesës së kuorumit të shtyhet mbajtja e mbledhjeve as të kuvendit e as komiteteve edhe pse ndonjëherë ka pasur mungesa të arsyeshme po edhe të pa arsyeshme nga anëtarët e kuvendit dhe anëtarët e komiteteve. Sa i përket punës dhe efikasitetit të kuvendit komunal dhe trupave të tij, gjatë periudhës raportuese kuvendi ka nxjerrë dhe miratuar 29 (njëzet e nëntë) vendime, si dhe 3 (tri) Rregullore. Të gjitha aktet e miratuara nga kuvendi dërgohen në Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal për shqyrtimin e ligjshmërisë së tyre. Deri me tani të gjitha këto materiale janë dërguar brenda afatit të caktuar, në të dy gjuhët zyrtare si dhe është marrë konfirmimi nga ministria lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së këtyre akteve. Pas shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve ato janë publikuar në ueb faqen e komunës.

QENDRA PËR SHËRBIM ME QYTETARË

Numri i kërkesave sipas Drejtorive, për një vit:

| Nr. | Drejtorit/Departamenti                         | Të pranuara | Të arkivuara |
|-----|------------------------------------------------|-------------|--------------|
| 00  | Kuvendi Komunal                                | 03          | 04           |
| 001 | Kryetari i Komunës                             | 158         | 20           |
| 02  | Drejtoria për Administratë dhe Personel        | 87          | 294          |
| 03  | Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë     | 2051        | 1296         |
| 04  | Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim             | 80          | 54           |
| 05  | Drejtoria për Arsim                            | 681         | 1030         |
| 06  | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale | 221         | 144          |
| 07  | Drejtoria për Punë të Inspeksionit             | 96          | 08           |
| 08  | Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri      | 726         | 131          |
| 08  | Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural       | 423         | 142          |
| 10  | Zyra Lokale e Komuniteteve                     | 84          | 03           |
| 11  | Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis      | 355         | 87           |
| 12  | Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport          | 46          | 49           |
| 13  | Drejtoria për Buxhet dhe Financa               | 32          | 14           |

|           |                       |
|-----------|-----------------------|
| Gjithsej: | 5.043+3.276<br>=8.319 |
|-----------|-----------------------|

Numri i dokumenteve të lëshuara/ proceduara/protokolluara për një vit:

| Nr. | Lloji i dokumentit                                                       | Totali |
|-----|--------------------------------------------------------------------------|--------|
| 1   | Deklaratë për Mbajtës të Familjeve                                       | 250    |
| 2   | Vërtetime, Legalizime                                                    | 340    |
| 3   | Vulosje                                                                  | 12.500 |
| 4   | Protokolli dalës shkresa të Ministrive të protokolluara                  | 109    |
| 5   | Ekspedimi i postës Rek. dërgesave në postë- përgjigje nga Drejtoritë K.K | 447    |
| 6   | Pranimi i dërgesave nga posta në K.K-Istog                               | 743    |

|           |       |
|-----------|-------|
| Gjithsej: | 1.889 |
|-----------|-------|

Pagesat e Administratës për një vit:

| Nr. | Lloji i dokumentit      | Shuma(€) |
|-----|-------------------------|----------|
| 1   | Pagesat e Administratës | 3.500    |
| 2   | Pagesat në Arkë-QSHQ    | 1.896    |

I. Të liruar nga pagesa për një vit:

|            |       |
|------------|-------|
| Të liruar: | 1.604 |
|------------|-------|

## SEKTORI PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE KOMUNITETE

Në pajtim me Udhëzimin Administrativ të MAPL-së është formuar **Spektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete** si mekanizëm monitorues për respektimin e të drejtave të njeriut në relacionin komunë-qytetarë, i cili funksion si sektor/njësi e veçantë në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale.

Misioni i **Spektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete** është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe reagimi për vënien e tyre në vend, sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, përmirësimi i akteve nënligjore komunale, praktikës për zbatimin e këtyre akteve, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, mundësi të barabarta dhe mos diskriminim, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve, kundër trafikimit me qenie njerëzore, personat me aftësi të kufizuara.

Gjatë këtij viti, kjo zyre për shkak të gjendjes së krijuar si pasojë e pandemisë COVID '19 nuk ka arritur të realizoj shumicën e aktiviteteve që kanë qenë të planifikuara të mbahen.

Janë monitoruar mbledhjet e Kuvendit Komunal, dëgjimeve me qytetarë, mbledhjet e KPF-së dhe takime tjera në kuadër të komunës.

Pjesëmarrje në trajnime të ndryshme qoftë me pjesëmarrje fizike apo përmes platformës Zoom.

- Trajnim "Trajnim për Ligjin për Zyrtarë Publikë" maj 2021;
- Trajnim "Rëndësia e lokalizimit të OZHQ-ve dhe ndikimet e tyre në komunën tuaj" 04.06.2021;
- Trajnim "Buxheti gjinor" 7 dhe 8 Qershor, 2021;
- Trajnim "Publikimi i raporteve/procesverbaleve nga konsultimet publike" 1-2 Korrik 2021;
- Forum të nivelit të lartë politik të titulluar "Integrimi i Agjendës 2030 në kuadrin e planifikimit strategjik në Kosovë", 24-25 Nëntor 2021.

Nga periudha qershor-dhjetor 2021 janë mbajtur disa aktivitete të parapara me planin e punës.

- Punëtori me temën "Organizimi dhe sensibilizimi i femrës në vendimarrje" me qëllim të diskutimit rreth sensibilizimit të grave në shoqëri për rolin vendimarrës të tyre, shkëmbimin e përvojave të shqiptarëve që jetojnë brenda dhe jashtë Kosovës.



- Tryezë të rrumbullakët në rastin e shënimit të 15-Tetorit-“Dita Ndërkombëtare e Shkopit të Bardhë”, tema kryesore e kësaj tryeze ishte: “Sfidat dhe të arriturat e personave të verbër si dhe realizimi i të drejtave të tyre”





- "16 Ditët e aktivizimit kundër dhunës në familje" OJQ "Folklori i Podgurit" ka mbajtur aktivitete e parapara nga data 25.11.2021 deri 10.12.2021, ku pjesë e disa takimeve me qëllim monitorimi ishim edhe ne.









Komuna Istog



## Dhuna në familje

*Thyej heshtjen, thuaj JO dhunes ndaj gruas*



Trajner : Ismet Demaj

Operator: Faton Bytyçi

- Tryezë të rumbullakët në rastin e shënimit të 3- Dhjetorit, " Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara", me qëllim të mbështetjes së tyre dhe diskutimit të përbashkët për mbrojtjen e të drejtave të tyre, ofrimin e qasjes, pjesëmarrjen e

tyre në sfera të ndryshme të shoqërisë, sfidat dhe vështirësitë e tyre përgjatë përditshmërisë.



- Shënimi i 10 Dhjetorit - Dita Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut është mbajtur edhe një tryezë e rrumbullakët me temën " Respektimi i të Drejtave të Njeriut".







Republika e Kosovës  
Republika Kosova



Komuna e Istogut  
Opstina Istok

## R A P O R T I P U N Ë S S Ë KUVENDIT KOMUNAL PËR VITIN 2021

### Qëllimi

Ky raport, para së gjithash ka për qëllim informimin e drejtë dhe të saktë të institucioneve qendrore dhe komunale e mbi të gjitha informimin e qytetarëve të Komunës së Istogut, organizatave joqeveritare, shoqërisë civile dhe çdo grupi tjetër të interesit, për nivelin e angazhimit dhe funksionimit të Kuvendit Komunal karshi sistemit juridik të vendit dhe obligimeve që dalin nga ky sistem.

Në këtë Raport janë përfshirë të dhënat e përgjithshme të punëve dhe aktiviteteve të Kuvendit Komunal dhe trupave të Kuvendit sipas Planit vjetor të punës së Kuvendit, mandatit dhe përgjegjësisë.

Vlerësojmë se prezantimi dhe pasqyrimi i aktiviteteve të Kuvendit në këtë Raport gjatë kësaj periudhe raportuese do të shërbej si një tregues i realizimit të objektivave dhe sfidave të Kuvendit e që për qëllim në proceset reformuese kanë ngritjen e transparencës së Kuvendit, përgjegjësisë dhe efikasitetit në punë të anëtarëve të Kuvendit dhe ekzekutivit të Komunës.

Prandaj nga këndvështrimi ligjor, sipas nenin 4 të LVQL dhe nenit 1. të Statutit të Komunës së Istogut, Komuna përkufizohet si njësi themelore e organizimit të pushtetit dhe vetëqeverisjes lokale në Republikën e Kosovës e përbërë nga të gjithë qytetarët në kuadër të territorit të përcaktuar me ligj, ndërkaq në bazë të nenit 10 të te njëjtë ligj dhe nenit 11 të Statutit të Komunës organet kryesore të Komunës janë Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës.

Nga ky përkufizim ligjor, Kuvendi i Komunës definohet si organi më i lartë përfaqësues dhe vendimmarrës i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejt me mandat 4-të vjeçar.

### *Raporti i punës*

### **Përbërja e Kuvendit:**

Kuvendi Komuna në bazë të nenit 36 par.36.1 pika d) përbëhet prej 27 anëtarëve të zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët me të drejtë vote në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale me mandat 4-tër vjeçar.

### **Struktura dhe përfaqësimi i Kuvendit:**

Kuvendi Komunal u zgjodh në zgjedhjet e mbajtura me datë 22.10.2017 ku dhanë betimin të gjithë anëtarët e Kuvendit me datë 05.01.2018, zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit u bë me datën 03.02.2018 nga radhët e LDK- së z. Qaush Balaj. Kuvendi i Komunës së Istog përbëhet nga 27 (njëzet e shtatë) anëtarë të Kuvendit dhe përfaqësohet nga 6 (gjashtë) subjekte politike dy kandidat të pavarur.

- |                |                     |               |
|----------------|---------------------|---------------|
| 1. LDK -       | përfaqësohet me ... | 11. anëtar,   |
| 2. AAK- “ / “  | me ...              | 6. anëtar     |
| 3. PDK - “ / “ | me...               | 4. anëtar     |
| 4. VV - “ / “  | me...               | 2. anëtar,    |
| 5. IQ - “ / “  | me...               | 1. anëtar,    |
| 6. SL - “ / “  | me...               | 1. anëtar,    |
| 7. RB - “ / “  | me ..               | 1. anëtar dhe |
| 8. SM - “ / “  | me ...              | 1. anëtar.    |

Për më tepër 30 % e numrit të anëtarëve të Kuvendit përfaqësohet nga gjinia femërore, ndërsa karakteristikë e kësaj është se 90% e përfaqësimit të tyre në Kuvend vijnë në bazë të numrit të votave të fituara drejtë për së drejti nga zgjedhësit e jo vetëm për plotësimin e kuotës.

### **Komitetet dhe Këshillat e Kuvendit të Komunës**

Që në mbledhjen e parë të rregullt Kuvendi i Komunës në legjislaturën e gjashtë në kuadër të Kuvendit të Komunës në bazë të ligjit janë themeluar dy Komitete obligative, Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komiteti për Komunitete (KK) me mandat 4-tër vjeçar.

Komiteti për Politikë dhe Financa përbëhet prej 7.anëtarëve: 3. nga radhët e LDK, 2 nga AAK dhe 1. nga PDK, si dhe Kryesuesi i Kuvendit i cili me automatizëm është anëtar por edhe kryesues i Komitetit për Politik e Financa të gjithë anëtarë të Kuvendit. Në këtë komitet gjinia femërore përfaqësohet me tri anëtare, ndërkaq, Komiteti për Komunitete përbëhet prej 7 anëtarëve : një nga radhët e LDK, një nga AAK, një nga PDK, anëtari i pavarur nga SM dhe kryesuesi i Komitetit i pavarur RB, dhe dy nga shoqëria civile të cilët nuk janë anëtar të Kuvendit. Ky komitet përfaqësohet me tri femra.

### ***Raporti i punës***

Duke u bazuar në Udhëzimet Administrative përkatëse, me propozim të kryetarit të Komunës e me Vendim të Kuvendit të Komunës është themeluar edhe Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) prej 23 anëtarëve dhe Grupi joformal i grave asambleiste të Kuvendit të Komunës me mandat 4 vjeçar.

Përveç themelimit të dy Komiteteve obligative, Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe Grupit jo formal të Grave që në fillim të mandatit.

Kuvendi i Komunës ka themeluar edhe tri Komitete Konsultative gjatë viti 2019 si: Komuniteti Konsultativ për Arsim, Komitetin Konsultativ për Shërbime Publike dhe Komiteti Konsultativ për Shëndetësi, këto komitete u themeluan në bazë të procedurave të cekura në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.01/2016 për Procedurën e Themelimit Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, dhe përbëhen nga 5 anëtarë.

Këto komitete të cekura kanë vazhduar punën e tyre dhe kanë mbajtur nga 4 (katër) mbledhje po në këtë vit, me disa vështirësi por kanë dalë me disa rekomandime të cilat ua kanë prezantuar ekzekutivit,

Sipas planit të punës në vazhdimësi sipas nevojës janë formuar edhe komisione dhe grupe punuese me karakter të përkohshëm.

*Vlen të theksohet se gjatë këtij viti që po lëmë pas Kuvendi i Komunës nuk ka mundur që ti përmbahet me përpikëri Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2020, për shkak të gjendjes që ka përfshirë të gjithë botën COVID 19, janë shqyrtuar dhe miratuar vetëm pikat me kryesore për funksionimin e Kuvendit të Komunës.*

*Po në këto mbledhje jemi mundur që sa më shumë ti përmbahemi rekomandimeve kundër Covid 19 .*

*Kemi pasur disa nga anëtarët e Kuvendit që për shkak të infektimit të tyre apo të ndonjë anëtari të familjes së tyre apo kontakti fizik me të infektuarit me Covid 19, nuk kanë marrë pjesë në mbledhje, dhe kanë dhënë arsyetimin. Fatmirësisht edhe këto raste kanë qenë të pakta.*

### **Puna , aktivitetet dhe efikasiteti i Kuvendit Komunal dhe trupave të saj**

Kuvendi i Komunës, në pajtim me funksionimin dhe kompetencat që ka në bazë të nenit 40 të LVL por edhe përgjegjësi të tjera ligjore dhe planit vjetor me përgjegjësi dhe përkushtim gjatë kësaj periudhe raportuese Kuvendi i Komunës ka mbajtur 7 (Shtatë) mbledhje të rregullta , 5 (pesë) mbledhje të jashtëzakonshme, 2 (dy) solemne si dhe 3 (tri) dëgjim me qytetarë, me një pjesëmarrje jo të duhur të qytetarëve duke ju përmbajtur edhe rekomandimeve të IKPSHK-së, kundër Covid 19.

Viti 2021 ka qenë vit zgjedhor dhe kuvendi i komunës ka mbajtur mbledhje veten deri në muajin shtator. Zgjedhjeve lokale të cilat u mbajtën me 14 nëntor 2021. Pas certifikimit të Kuvendeve të Komunës.

Kuvendi i Komunës së Istogut, thirri mbledhjen Inauguruese me 06 dhjetor 2021, ku të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës (27 anëtar të KK) dhe Kryetari i Komunës dhanë betimin (u betuan solemnisht).

### ***Raporti i punës***



Kuvendi për mandat katër vjeçar të legjislaturës së VII përfaqësohet nga 5 (pesë) subjekte politike, si me poshtë:

1. LDK – përfaqësohet me ... 11. anëtar,
2. AAK- “ / “ me ... 7. anëtar
3. LVV - “ / “ me... 5. anëtar
4. PDK - “ / “ me... 3. anëtar,
5. GIBI- “ / “ me... 1. anëtar,

Gjatë vitit 2021 kuvendit ka trajtuar dhe shqyrtuar gjithsej 77 ( Shtatëdhjetë e shtatë) pika të rendit të ditës duke llogaritur edhe pikat e zakonshme të rendit të ditës, arsyetimi i mungesave, miratimi i procesverbaleve dhe pyetje nga anëtarët e KK. Për më tepër të gjitha këto pika të rendit të ditës, paraprakisht janë trajtuar dhe shqyrtuar edhe në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa për të cilat komiteti ka nxjerrë rekomandime dhe i ka dërguar Kuvendit për shqyrtim dhe miratim. Është me rëndësi të thuhet se pothuajse të gjitha rekomandimet e KPF-së të dërguar në Kuvend për shqyrtim janë mbështetur dhe përkrahur në mënyrë unanime, gjë që tregon një bashkëveprim në mes tyre.

Ndërkaq, Komiteti për Komunitete gjatë kësaj periudhe raportuesi i ka mbajtur gjithsej 8 (tetë) mbledhje. Në vështrim të pjesëmarrjes së anëtarëve në mbledhje të thirrura nuk ka ndodhë asnjëherë që për shkak të mungesës së kuorumit të shtyhet mbajtja e mbledhjeve as të Kuvendit e as Komiteteve edhe pse ndonjëherë ka pasur mungesa të arsyeshme po edhe të pa arsyeshme nga anëtarët e Kuvendit dhe anëtarët e komiteteve.

Sa i përket punës dhe efikasitetit të Kuvendit të Komunës dhe trupave të saj, gjatë periudhës raportuese Kuvendi ka nxjerrë dhe miratuar 29 ( njëzet e nënte ) Vendime, si dhe 3 (tri) Rregullore.

Kuvendi ka mbajtur edhe 2 (dy) dëgjime publike me qytetarë për planifikimin e buxhetit për vitin 2022-2024 me pjesëmarrjen e anëtarëve të Kuvendit , me anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa me një pjesëmarrje modeste të qytetarëve.

Për çdo mbledhje të Kuvendit të Komunës në rend dite ka qenë e paraparë pika pyetje nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, dhe në kuadër të kësaj anëtarët e Kuvendit gjatë mbledhjeve të Kuvendit të Komunës kanë parashtruar pyetje për ekzekutivin e komunës, disa nga të cilave ju është dhënë përgjigje e menjëhershme nga kryetari dhe nga drejtoret përkatës dhe disa kanë marrë përgjigje në mbledhjet e vijuese, apo me shkrim përmes email adresës elektronike.

Pyetjet nga anëtarët e Kuvendit drejtuar ekzekutivit kanë qenë të pakta të drejtuara me shkrim, që kjo do të ishte me efikase dhe një përgjigje më e detajuar për anëtarët e Kuvendit.

Nga anëtarët e Kuvendit në përgjithësi nuk ka pasur mungesa të shumta, por ka edhe nga të cilat ku disa nga anëtarët e Kuvendit vetëm nënshkruhen në listën e mëditjes dhe pas miratimit të rendit të ditës e lëshojnë mbledhjen, kjo tregon një papërgjegjësi dhe mosrespektim ndaj anëtarëve tjerë dhe ndaj votuesve të tyre.

### **Marrëdhëniet e Kuvendit Komunal me institucionet qendrore, lokale dhe organizatat tjera**

Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi me institucionet qendrore e posaçërisht me MAPL-në, si autoritet mbikëqyrës i qeverisjes lokale, ka qenë në nivel të mirë. Sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve, me kohë sipas LVL ka dërguar të gjitha vendimet e miratuara në Kuvend ka dërguar për shqyrtimin e ligjshmërisë me kohë. Vërejtje mund të japim për disa vonesa në konfirmimin e shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve.

Kuvendi i Komunës gjatë kësaj periudhe bashkëpunim shumë të mirë dhe të suksesshëm në përgjithësi ka pasur edhe me ekzekutivin e Komunës e në veçanti me kryetarin e Komunës i cili jo vetëm që ka qenë prezent pothuajse në të gjitha mbledhjet e Kuvendit dhe Komitetit për Politikë dhe Financa por që gjatë këtyre mbledhjeve ka qenë shumë i hapur, konstruktiv, i përkushtuar, kritik por edhe vetëkritik si dhe kreator dhe iniciues i shqyrtimit të shumë çështjeve të rëndësishme me interes të përgjithshëm.

Pa dyshim se bashkëpunim të mirë kemi pasur edhe me Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK) e në veçanti me Kolegjin e Kryesuesve të Kuvendeve Komunale i cili vepron në kuadër të këtij Asociacioni, anëtar i të cilit jemi edhe ne. Pastaj me OSBE-në, Policinë e Kosovës, KFOR-in, shoqërinë civile, grupet e interesit, qytetarët dhe mediat.

Ndërkaq, e veçanta e këtij Kuvendi gjatë kësaj periudhe ka qenë krijimi dhe ndërtimi i marrëdhënieve të shëndosha në mes anëtarëve, qasja parimore dhe konstruktive ndaj çështjeve të shtruar për diskutim si një tregues real i kultivimit dhe zhvillimit të një demokracie të shëndetshme brenda Kuvendit, si dhe qëndrimi objektiv dhe i përgjegjshëm i anëtarëve ndaj çështjeve me interes të përgjithshëm dhe interesit të qytetarëve të cilët i përfaqësojnë.

### **Sfidat e Kuvendit Komunal gjatë periudhës raportuese.**

Aktualisht, gjatë kësaj periudhe raportuese Kuvendi i Komunës përveç sukseseve ka pasur edhe sfida dhe probleme në realizimin e objektivave dhe synimeve të saj. Një ndër sfidat më të theksuara gjatë punës së Kuvendit për vitin që po e lëmë pas ka qenë çështja inferioriteti dhe mos interesimi i qytetarëve por edhe shoqërisë civile në përgjithësi në Debate Publike në shfrytëzimin e të drejtës dhe fuqizimin e rolit të tyre në vendimmarrje. Prandaj, kjo do të mbetet si sfidë edhe në të ardhmen dhe obligim i yni për të gjetur format më të mira për motivimin dhe zgjimin e interesimit të tyre në shfrytëzimin e të drejtës dhe ndikimit që mund të kenë ndaj institucioneve në

vendimmarrje me propozimet e tyre gjatë debateve publike të organizuara nga Kuvendi i Komunës.

Ndonëse rezultatet e arritura gjatë këtij viti raportues kanë qenë mjaft inkurajuese, po kjo duhet të na shërbejë si motivim më i madh në angazhimin dhe përkushtimin tonë të përbashkët për realizimin e të gjitha objektivave dhe synimeve të planifikuara për një të ardhme më të mirë, më shpresëdhënëse dhe më prosperitet dhënëse për të gjithë qytetarët e komunës sonë, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike, gjinore, fetare, racore dhe politike.

Me dt.

Kryesuesi i Kuvendit,

I s t o g